VËLLIMI XXXIV /KORRIK-SHTATOR/ 2026

VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS 2026

BULETINI ZYRTAR

AUTORITETI I KONKURRENCËS

PËRMBAJTJA

Nr.1307, Datë 24.07.2026 ..... **5**

"PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJEVE VODAFONE ALBANIA SHA DHE ONE ALBANIA SHA NË TREGUN ME PAKICË TË SHËRBIMEVE CELULARE DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE"

Nr.1308, Datë 24.07.2026 ..... 2**1**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT NËPËRMJET BLERJES SË 50% TË KUOTAVE, TË SHOQËRISË KS HUAYU ALUTECH GMBH NGA SHOQËRIA PORSCHE INVESTMENTS MANAGEMENT S.A."

Nr.1309, Datë 24.07.2026 ..... **25**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË ITALIA TRASPORTO AEREO S.P.A. NGA SHOQËRIA DEUTSCHE LUFTHANSA AKTIENGESELLSCHAFT"

Nr.1310, Datë 24.07.2026 ..... **30**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM ŞIRKETI NGA SHOQËRIA EKIN MADEN TICARET VE SANAYI ANONIM ŞIRKETI."

Nr.1311, Datë 17.08.2026 ..... **33**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ENSO HYDRO ENERGJI SHPK NGA SHOQËRIA ALBASTEEL PCP SHPK"

Nr.1312, Datë 17.08.2026 ..... **37**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRIVE MARKETING INVESTMENT GROUP CR LLC, MARKETING INVESTMENT GROUP CZECH S.R.O., MIG MARKETING INVESTMENT GROUP RO SRL, MARKETING INVESTMENT GROUP BULGARIA EOOD, MARKETING INVESTMENT GROUP SLOVAKIA S.R.O., MARKETING INVESTMENT GROUP SR D.O.O., MARKETING INVESTMENT GROUP HUNGARY KFT. NGA SHOQËRITË E GRUPIT SPORT VISION"

Nr.1313, Datë 17.08.2026 ..... **42**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TH. NITSIAKOS AVEE PTINOTROFIKES EPICHEIRISEIS NGA SHOQËRITË PERUTNINA PTUJ D.O.O. DHE FAMILJA NITSIAKOS"

Nr.1314, Datë 17.08.2026 ..... **47**

"PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE I-FIRE SHPK DHE P.F. AERD MAHMUTAJ"

Nr.1315, Datë 17.08.2026 ..... **52**

"PËR VENDOSJEN E GJOBËS PERIODIKE DITORE NDAJ NDËRMARRJES TIRANA ADMINISTRIM SHPK PËR MOSPËRMBUSHJEN E DETYRIMIT PËR DEPOZITIMIN E INFORMACIONIT NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1304, DATË 26.06.2026"

Nr.1316, Datë 17.08.2026 ..... **57**

MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT "MBI PËRKUFIZIMIN E TREGUT PËRKATËS."

Nr.1317, Datë 17.08.2026 ..... **58**

MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT "PËR IMUNITETIN NGA GJOBAT DHE LEHTËSIMIN E GJOBAVE NË RASTET E MARRËVESHJEVE TË NDALUARA."

Nr.1318, Datë 17.08.2026 ..... **59**

MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT"PËR VLERËSIMIN E MARRËVESHJEVE TË NËNKONTRAKTIMIT NË LIDHJE ME NENIN 4 TË LIGJIT 9121/2003".

Nr.1320, Datë 11.09.2026 ..... **60**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË BUSINESS LEASE HUNGARY KFT. NGA SHOQËRIA MERKANTIL BANK ZRT."

Nr.1321, Datë 11.09.2026 ..... **64**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË CELLCENTRIC GMBH & CO. KG NGA SHOQËRITË TOYOTA MOTOR CORPORATION, AKTIEBOLAGET VOLVO DHE DAIMLER TRUCK AG".

Nr.1322, Datë 11.09.2026 ..... **68**

"MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 1181, DATË 05.06.2025 "MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK NGA SHOQËRIA UNION BANK SHA"

Nr.1323, Datë 11.09.2026 ..... **72**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË EVERLLENCE SE NGA SHOQËRITË VOLKSWAGEN AKTIENGESELLSCHAFT DHE NIKOLAUS (BC) BIDCO GMBH".

Nr.1324, Datë 11.09.2026 ..... **76**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË LUMINOR HOLDING AS NGA SHOQËRIA OTP BANK NYRT."

Nr.1325, Datë 11.09.2026 ..... **79**

"PËR VAZHDIMIN E PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR MIDIS SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR KARTONIN JESHIL"

Nr.1326, Datë 11.09.2026 ..... **89**

"PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT

MBI MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME LEZHË SHA"

Nr.1327, Datë 11.09.2026 ..... **95**

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES

"PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR ZBATIMIN E NENEVE 4 DHE 9 TË LIGJIT NR. 9121/2003 NË SEKTORIN E TRANSPORTIT DETAR, PËRFSHIRË KABOTAZHIN DHE SHËRBIMET NDËRKOMBËTARE TË LUNDRIMIT TË LIRË (TRAMP SERVICES)"

Nr.1328, Datë 28.09.2026 ..... **96**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM, TË PROPOZUAR, PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË BANCA MONTE DEI PASCHI DI SIENA S.P.A. NGA SHOQËRIA INTESA SANPAOLO S.P.A."

Nr.1329, Datë 28.09.2026 ..... **99**

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË IRCA GROUP LUXEMBOURG MIDCO 4 S.À.R.L. NGA SHOQËRIA IBERT INVESTMENTS S.À.R.L.".

VENDIM

Nr.1307, Datë 24.07.2026

"PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJEVE VODAFONE ALBANIA SHA DHE ONE ALBANIA SHA NË TREGUN ME PAKICË TË SHËRBIMEVE CELULARE DHE DHËNIEN E KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.07.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënia e kushteve dhe detyrimeve.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 45, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative".

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Raportit të hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe pas përfundimit të dëgjesave me ndërmarrjet subjekt i hetimit të thelluar:

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur

1. Autoriteti i Konkurrencës, në ushtrimin e kompetencave të tij sipas Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet në tregun e komunikimeve elektronike, duke qenë se ky treg përfaqëson një sektor me rëndësi të veçantë për ekonominë kombëtare dhe interesat e konsumatorëve. Në vijim të monitorimeve të kryera ndër vite, Komisioni i Konkurrencës ka miratuar një sërë rekomandimesh me qëllim rritjen e transparencës, forcimin e konkurrencës dhe përmirësimin e funksionimit të këtij tregu.

2. Nisur nga ankesat e depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës gjatë viteve 2024–2025 lidhur me rritjen e çmimeve të paketave celulare dhe ndryshimet e kushteve tregtare të aplikuara nga ndërmarrjet Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA, si dhe nga rezultatet e monitorimit të tregut me pakicë të shërbimeve celulare, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1156, datë 29.01.2025, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj këtyre ndërmarrjeve, për periudhën 1 janar 2022 – 25 korrik 2025.

3. Gjatë procedurës së hetimit paraprak u administrua informacion i gjerë nga ndërmarrjet objekt hetimi dhe nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), u analizuan pjesët e tregut, zhvillimet tarifore, struktura e paketave, kontratat e pajtimtarëve, metodologjitë e përllogaritjes së kostove, si dhe dokumentacioni mbi vendimmarrjen për ndryshimet e ofertave tregtare.

4. Nga analiza e informacionit të administruar gjatë hetimit paraprak rezultuan elemente që justifikonin vijimin e procedurës hetimore, për shkak të karakteristikave strukturore të tregut, nivelit të lartë të përqendrimit, evolucionit të çmimeve dhe ofertave tregtare, si dhe nevojës për një vlerësim më të thelluar ekonomik dhe juridik të sjelljes së ndërmarrjeve.

5. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1226, datë 18.11.2025, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare, për periudhën 1 janar 2022 – 18 nëntor 2025.

6. Në kuadër të hetimit të thelluar, Autoriteti i Konkurrencës ushtroi të gjitha kompetencat hetimore të parashikuara nga Ligji nr. 9121/2003, duke administruar informacion të detajuar nga ndërmarrjet objekt hetimi dhe AKEP, duke kryer inspektime, verifikime dokumentare dhe analiza ekonomike mbi funksionimin e tregut.

7. Gjatë zhvillimit të procedurës hetimore u krye një analizë e plotë ekonomike dhe juridike e tregut me pakicë të shërbimeve celulare, duke u shqyrtuar struktura dhe karakteristikat e tregut, pjesët e tregut sipas të ardhurave dhe përdoruesve, niveli i përqendrimit, evolucioni i paketave me parapagesë, me kontratë dhe i shërbimeve roaming, metodologjitë e përllogaritjes së kostove, pasqyrat financiare të ndërmarrjeve, termat dhe kushtet kontraktore, praktikat e marketingut dhe transparencës, si dhe dokumentacioni i brendshëm lidhur me procesin e hartimit dhe miratimit të paketave tarifore, me qëllim vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg dhe përputhshmërisë së saj me dispozitat e Ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

II. Tregu përkatës

8. Tregu objekt i hetimit është tregu me pakicë i shërbimeve celulare, në të cilin shërbimi përkatës konsiston në ofrimin e aksesit në rrjet dhe të thirrjeve dalëse, përmes paketave të ofruara me parapagim dhe me kontratë nga ndërmarrjet operuese. Ky shërbim është i lëvizshëm, pra i aksesueshëm për përdoruesin në çdo kohë dhe vend, të paktën brenda

zonës së mbulimit të operatorit përkatës. Telefonia fikse nuk përfshihet në këtë treg, për shkak të karakteristikave të ndryshme që ka në raport me telefoninë celulare. Nga pikëpamja e përdoruesve, këto dy lloje shërbimesh nuk janë të zëvendësueshme me njëra-tjetrën.

9. Në tregun në shqyrtim veprojnë dy ndërmarrje që ofrojnë shërbime celulare dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre në të dy nivelet e tregut – si në segmentin me shumicë, ashtu edhe në atë me pakicë. Të dy operatorët janë të integruar vertikalisht dhe ofrojnë gjithashtu shërbimin e terminimit për konkurrentët e tyre.

10. Bazuar në sa më sipër, tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha shërbimet publike të telefonisë celulare të ofruara nga operatorët në tregun me pakicë.

11. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën ku ndërmarrjet ofrojnë dhe konsumatorët kërkojnë shërbimin, dhe ku kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëm homogjene. Në rastin konkret, territori ku operatorët celularë zhvillojnë aktivitetin e tyre, në përputhje me licencat përkatëse, është territori i Republikës së Shqipërisë.

12. Bazuar në sa më sipër, tregu përkatës përkufizohet si tregu i shërbimeve publike të telefonisë celulare – që përfshin aksesin në rrjetin celular nga përdoruesit fundorë, si dhe të gjitha llojet e thirrjeve dalëse, SMS-ve dhe aksesit në internet broadband – të ofruara nëpërmjet paketave me parapagim dhe me kontratë nga ndërmarrjet Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë

III. Pjesët e Tregut

13. Nga vlerësimi i kriterit të pjesëve të tregut rezulton se:

- Duke vlerësuar treguesit e të ardhurave totale të kompanive për periudhën 2022 - 2024, rezulton se ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu për të tre vitet është XXX me përkatësisht XXX% në vitin 2022, XXX% në vitin 2023, XXX% në vitin 2024 dhe XXX% deri më 18 nëntor të 2025. Ndërkohë, XXX ka zotëruar përkatësisht XXX% në 2022, XXX% në 2023, XXX% në 2024 dhe XXX% për periudhën 1 janar – 18 nëntor 2025.
- Nga pjesët e tregut sipas të ardhurave në retail për periudhën 2022 - 2024, rezulton se ndërmarrja me pjesë më të madhe tregu për të tre vitet është XXX me pjesë tregu që luhatet nga XXX% (2022), XXX% (2023) në XXX% (2024), XXX% në periudhën 1 janar – 18 nëntor 2025. Ndërmarrja tjetër XXX zotëron pjesën tjetër të tregut ose XXX% në vitin 2022, XXX% (2023), XXX% (2024) dhe XXX% në periudhën 1 janar – 18 nëntor 2025.
- Duke vlerësuar kriterin sipas pajtimtarëve me paspagesë (kontratë) në tregun përkatës rezulton se: ndërmarrja XXX ka ruajtur XXX të tregut në këtë segment me XXX% në

vitet 2022 dhe 2023, XXX% në vitin 2024 dhe XXX% për periudhën 1 janar – 18 nëntor 2025. Ndërmarrja XXX ka zotëruar përkatësisht XXX% në vitet 2022 dhe 2023, XXX% në vitin 2024 dhe XXX% në 1 janar – 18 nëntor 2025.

- Duke vlerësuar kriterin sipas pajtimtarëve me parapagesë në tregun përkatës rezulton se: Ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut për periudhën në hetim është XXX në vitin 2022 me XXX% dhe XXX me XXX% në vitin 2023, XXX% në vitin 2024 dhe XXX% në periudhën 1 janar – 18 nëntor 2025.
- Duke vlerësuar kriterin sipas pajtimtarëve me parapagesë, vetëm segmenti i paketave mujore standarde në tregun përkatës rezulton se: ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut për vitin 2022 është XXX me XXX%, ndërsa XXX me XXX%. Në vitet pasuese, 2023 dhe 2024, XXX zotëron përkatësisht XXX% dhe XXX%. Në periudhën 1 janar – 18 nëntor 2025 XXX kalon sërish si operatori me pjesën më të madhe të këtij segmenti tregu me XXX%.
- Duke vlerësuar kriterin sipas të ardhurave nga shërbimi roaming në tregun përkatës rezulton se: gjatë periudhës 2022–2024, XXX ka mbajtur pjesën më të madhe të tregut në këtë segment: XXX% në 2022, XXX% në 2023, XXX% në 2024 dhe XXX% në 1 janar – 18 nëntor 2025. XXX ka zotëruar pjesën tjetër me XXX%, XXX%, XXX% dhe XXX% përkatësisht.
- Bazuar në numrin total të kartave SIM për vitet 2022-2024, XXX zotëron XXX% (2022), XXX% (2023), XXX% (2024) dhe XXX% në periudhën 1 janar – 18 nëntor 2025. XXX përkatësisht: XXX%, XXX%, XXX% dhe XXX%.
- Sipas kriterit të përdoruesve aktivë me kartë SIM, vihet re se, në vitin 2022, XXX kryeson me XXX%, (XXX% XXX), ndërsa në vitet 2023 dhe 2024, XXX, me një pjesë të qëndrueshme prej XXX% (XXX% XXX) për t'a XXX në XXX% në periudhën 1 janar – 18 nëntor 2025 (XXX% XXX).
- Numri i thirrjeve dalëse ndjek të njëjtin trend me kartat SIM aktive. Në vitin 2022, XXX zotëron XXX%, ndërsa XXX XXX%. Në vitet 2023 dhe 2024, përkatësisht, XXX zotëron XXX% dhe XXX% për t'u XXX në XXX% në 1 janar – 18 nëntor 2025 (XXX% XXX).
- Nga volumi i të dhënave të konsumuara, përdoruesit e XXX konsumojnë më shumë. XXX zotëron XXX% në 2022, XXX% në 2023, XXX% në 2024 dhe me një XXX të lehtë në 1 janar – 18 nëntor 2025 me XXX%. XXX zotëron përkatësisht XXX%, XXX%, XXX% dhe XXX%.
- Në vitin 2022, XXX zotëron më shumë përdoruesve aktivë të internetit ose XXX% të tregut, ndërsa XXX XXX%. Në vitin 2023 dhe 2024, XXX kalon me përkatësisht XXX% dhe XXX%, ndërsa XXX XXX% dhe XXX%. Në periudhën 1 janar – 18 nëntor 2025, XXX zotëron XXX% dhe XXX vetëm XXX%.

IV. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun përkatës

i. Analiza e sjelljes së ndërmarrjes Vodafone Albania SHA

14. Në kuadër të hetimit të thelluar, ndërmarrja Vodafone Albania SHA vuri në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës informacion të detajuar mbi paketat me parapagesë, me kontratë dhe roaming për periudhën objekt hetimi, duke përfshirë emërtimet, çmimet, përmbajtjen e paketave, datat e hyrjes në fuqi të ndryshimeve, dokumentacionin mbi procesin e miratimit të ofertave tregtare, metodologjinë e ndjekur për përcaktimin e çmimeve, pasqyrat financiare, termat dhe kushtet kontraktore, si dhe informacion mbi praktikat e marketingut dhe reklamimit.

15. Nga analiza e paketave tarifore rezultoi se gjatë gjithë periudhës objekt hetimi, paketa Vodafone Basic, me vlerë 600 lekë dhe vlefshmëri 30 ditë, ka mbetur paketa me çmimin më të ulët e ofruar nga ndërmarrja për segmentin e individëve, pavarësisht ndryshimeve të ndërmarra në paketat e tjera me parapagesë dhe me kontratë.

16. Lidhur me afatet e vlefshmërisë së rimbushjeve dhe kalimin e një numri me parapagesë në status pasiv, ndërmarrja Vodafone Albania SHA ka sqaruar se një numër i ri Vodafone qëndron aktiv në rrjet për një periudhë 12-mujore. Pas përfundimit të kësaj periudhe, statusi i numrit varet nga kryerja e rimbushjeve nga pajtimtari, sipas afateve të përcaktuara. Data e skadimit të kreditit përcakton kohëzgjatjen e statusit aktiv, gjatë së cilës pajtimtari ka të drejtë të përdorë të gjitha shërbimet që i përkasin planit të tij tarifor. Në rast se pajtimtari nuk kryen rimbushje deri në datën e njoftuar, numri kalon në status pasiv dhe, 24 orë pas kalimit në këtë status, krediti i mbetur konfiskohet. Megjithatë, pajtimtari mund të marrë thirrje hyrëse për një periudhë prej 3 muajsh dhe, nëse kryen një rimbushje brenda kësaj periudhe, numri riaktivizohet. Gjithashtu, ndërmarrja ka sqaruar se pajtimtari ka mundësinë të rimarrë numrin e tij brenda një afati prej 2 vjetësh nga momenti i deaktivizimit të tij.

17. Në lidhje me afatet e vlefshmërisë së rimbushjeve për numrat me parapagesë, Vodafone Albania SHA ka bërë me dije se për rimbushjet me vlerë nga 100 deri në 499 lekë vlefshmëria është 30 ditë; për rimbushjet me vlerë nga 500 deri në 999 lekë vlefshmëria është 45 ditë; për rimbushjet me vlerë nga 1,000 deri në 2,500 lekë vlefshmëria është 60 ditë, ndërsa për rimbushjet me vlerë mbi 2,501 lekë vlefshmëria është 90 ditë.

18. Ndërmarrja Vodafone Albania SHA nuk ka një metodologji të mirëfilltë për përllogaritjen e kostove për hedhjen në treg të paketave me parapagesë, kontratë dhe roaming por shprehet se, i bazon vendimet komerciale në analiza të detajuara financiare. Ri-dizenjimi i portofolit të planeve me parapagesë dhe me kontratë ka ardhur në formë organike i bazuar në analizën e faktorëve (i) të brendshëm dhe të jashtëm, (ii) vendas dhe gjeo-politikë; Analiza e kostos së brendshme: investimet në rrjet, blerje/ri-balancim spektri, si dhe në tekonologjinë 5G; kushtet makroekonomike të tregut.

19. Si dhe ndërmarrja Vodafone Albania SHA mbi çmimin për njësi të përfshirë në paketat me parapagim, me kontratë dhe roaming është shprehur se, llogaritja e cmimit për njësi është teknikisht dhe ekonomikisht e vështirë për tu zbatuar në praktikë. Në vijim të kësaj përgjigjeje Vodafone Albania sqaron të gjitha arsyet teknike, ekonomike si edhe ligjore, me anë të të cilave vërteton vërshtirësitë dhe pamundësitë e përllogaritjes se cmimit për njësi për paketat në fjalë. Vodafone Albania thekson se në përputhje me legjislacionin për telekomunikacionin, praktikat rregullatore kryesisht të BE-së, vendosja e cmimit për njësi për paketat e kombinuara është teknikisht dhe ekonomikisht e pamundur, potencjalisht e pasaktë dhe ç'orientuese në mungesë të një metodologjie të unifikuar si edhe jo i detyrueshëm nga kuadri ligjor – rregullator kombëtar për telekomunikacionin.

20. Në fund të viteve 2022 dhe 2023, ndërmarrja Vodafone Albania SHA rezulton të ketë regjistruar një XXX neto prej XXX lekësh në vitin 2022, që përfaqëson XXX% të të ardhurave para **tatimit**, ndërsa në vitin 2023 ka realizuar një XXX neto prej XXX lekësh, ose XXX% të të ardhurave para tatimit**.** Ky XXX i rezultatit financiar është shoqëruar edhe me një XXX të të ardhurave prej rreth XXX% krahasuar me vitin paraardhës.

21. Gjatë vitit 2024, ndërmarrja Vodafone Albania SHA ka vijuar të XXX performancën e saj financiare, duke realizuar një XXX të të ardhurave prej XXX% dhe një XXX të kostove prej XXX%**,** çka ka sjellë XXX e normës së fitimit neto nga XXX% në vitin 2023 **në** XXX% në vitin 2024**.**

22. Në lidhje me përfshirjen e klauzolës së indeksimit të çmimeve sipas Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) në Termat dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, ndërmarrja Vodafone Albania SHA ka shpjeguar se iniciativa për përfshirjen e klauzolës së indeksimit sipas IÇK-së ka ardhur si rezultat i një direktive të Vodafone Group për të gjitha tregjet evropiane gjatë vitit 2022, duke marrë në konsideratë rritjen e inflacionit pas pandemisë. Sipas ndërmarrjes, klauzola është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar dhe atë evropian, pas konsultimeve me AKEP, dhe mbështetet në një tregues objektiv, konkretisht Indeksin e Çmimeve të Konsumit të publikuar nga INSTAT, si dhe në praktika të zbatuara në vende të tjera evropiane. Vodafone Albania SHA ka deklaruar se, megjithëse klauzola është përfshirë në Termat dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës që nga muaji prill 2024, ajo nuk është zbatuar për asnjë pajtimtar gjatë periudhës objekt hetimi (1 janar 2022 – 18 nëntor 2025**)**, pasi asnjë pajtimtar nuk kishte nënshkruar kontratën që përmbante versionin përfundimtar të kësaj klauzole përpara muajit prill 2024. Për rrjedhojë, sipas ndërmarrjes, gjatë periudhës objekt hetimi nuk është realizuar asnjë rritje e tarifave apo paketave si pasojë e aplikimit të klauzolës së indeksimit.

ii.Analiza e sjelljes së ndërmarrjes One Albania SHA

23. Në kuadër të hetimit të thelluar, ndërmarrja One Albania SHA vuri në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës informacion të detajuar mbi paketat me parapagesë, me kontratë dhe roaming për periudhën objekt hetimi, duke përfshirë emërtimet, çmimet, përmbajtjen e paketave, datat e hyrjes në fuqi të ndryshimeve, dokumentacionin mbi

procesin e miratimit të ofertave tregtare, metodologjinë e ndjekur për përcaktimin e çmimeve, pasqyrat financiare, termat dhe kushtet kontraktore, si dhe informacion mbi praktikat e marketingut dhe reklamimit.

24. Gjatë gjithë periudhës hetimore për ndërmarrjen One Albania SHA, paketa më ekonomike në treg për individë ka qenë One Lite, e cila u prezantua më 1 Qershor 2023 pas bashkimit të abonentëve të One Telecommunications dhe Albtelecom. Kjo paketë zëvendësoi paketën Unlimited S me përmbajtje të re dhe emërtim të ri, e cila për të njëjtën vlerë prej 600 ALL ofronte më shumë njësi komunikimi, me përmbajtje prej 500 MB, 100 minuta dhe 100 SMS kombëtare. Megjithatë, kur më 1 Gusht 2024 u përditësuan disa prej paketave të tjera me parapagesë si në përfitime ashtu edhe në çmim, One Lite mbeti e pandryshuar, duke ruajtur të njëjtën vlerë prej 600 ALL dhe vlefshmëri prej 30 ditësh nga momenti i aktivizimit.

25. Në lidhje me metodologjinë e përllogaritjes së kostove për hedhjen në treg të paketave me parapagesë, me kontratë dhe roaming, One Albania SHA ka deklaruar se nuk disponon një metodologji të mirëfilltë për këtë qëllim, por se vendimmarrja e saj mbështetet në metodologji të çmimeve të lidhura me inflacionin, të ngjashme me ato të përdorura nga operatorë të tjerë evropianë të sektorit të telekomunikacioneve. Sipas ndërmarrjes, zhvillimet globale dhe presionet inflacioniste në vendet e Bashkimit Evropian dhe në Shqipëri gjatë 2–3 viteve të fundit kanë sjellë rritje të konsiderueshme të kostove dhe shtrëngim të kushteve kontraktore. Gjithashtu, është shprehur se kjo rritje përbën pasojë të efektit zinxhir të transmetimit të inflacionit në marrëdhëniet kontraktore me palët e treta, duke sjellë rritje të kostove krahasuar me periudhën para vitit 2022.

26. Në lidhje me përllogaritjen e çmimit për njësi të shërbimeve të përfshira në paketat me parapagesë, me kontratë dhe roaming, One Albania SHA është shprehur se nuk disponon ekspertizë dhe as një metodologji të certifikuar për këtë qëllim. Ndërmarrja ka theksuar se, bazuar në analizat dhe informacionin e siguruar nga burime zyrtare, si BEREC dhe ITU, nuk ekziston ende një metodologji apo praktikë e unifikuar për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve të përfshira në paketat e kombinuara (bundle), për shkak të kompleksitetit dhe kufizimeve teknike e metodologjike që lidhen me mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për këto shërbime.

27. Në lidhje me afatet e vlefshmërisë së rimbushjeve për numrat me parapagesë, One Albania SHA ka sqaruar se për çdo rimbushje me vlerë nga 100 deri në 499 lekë**,** vlefshmëria e numrit shtyhet me 30 ditë nga data e rimbushjes; për rimbushjet me vlerë nga 500 deri në 1,200 lekë**,** vlefshmëria shtyhet me 45 ditë**;** për rimbushjet me vlerë nga 1,200 deri në 2,000 lekë**,** vlefshmëria shtyhet me 60 ditë; ndërsa për rimbushjet me vlerë mbi 2,000 lekë**,** vlefshmëria shtyhet me 180 ditë nga data e rimbushjes.

28. Për sa i përket kalimit të një numri me parapagesë në status pasiv, One Albania është shprehur se cikli i një karte të re SIM me parapagesë është 13 muaj, 12 muaj në status "aktiv" dhe 1 muaj në status "pasiv". Pas kësaj periudhe, 13 mujore, në rast moskryerje të asnjë rimbushjeje, abonenti kalon në statusin "pezulluar" për një periudhë 180 ditore. Me kryerjen e një rimbushjeje abonenti kalon sërish në status aktiv dhe mund të zgjedhë të aktivizojë lirisht planet tarifore që mund ti përshtaten pa kushte detyrime shtesë.

29. Në fund të viteve 2022 dhe 2023, ndërmarrja One Albania SHA rezulton të ketë regjistruar një XXX neto prej XXX lekësh në vitin 2022, që përfaqëson XXX% të të ardhurave para tatimit, ndërsa në vitin 2023 ka realizuar një XXX neto prej XXX lekësh, ose XXX% të të ardhurave para tatimit**.**

30. Gjatë vitit 2024, One Albania SHA ka regjistruar XXX lekë kosto shitjeje dhe XXX lekë të ardhura nga klientët. Krahasuar me vitin paraardhës, të ardhurat janë XXX me XXX%, ndërsa shpenzimet janë XXX me XXX%, duke bërë që norma e fitimit neto të XXX në XXX%**,** në krahasim me XXX% në vitin 2022 dhe XXX% në vitin 2023.

31. Në lidhje me përfshirjen e klauzolës së indeksimit të çmimeve sipas Indeksit të Çmimeve të Konsumit (IÇK) në Termat dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, ndërmarrja One Albania SHA ka deklaruar se përfshirja e klauzolës së indeksimit sipas IÇK-së u realizua pas një procesi konsultimi me AKEP gjatë viteve 2023–2024, duke iu referuar praktikave të operatorëve evropianë, kryesisht raporteve periodike të Cullen International për vitet 2023–2025 dhe burimeve të tjera publike. Sipas ndërmarrjes, klauzola synonte të përballonte rritjen e kostove operative, investimet në rrjetin 5G, rinovimin e autorizimeve dhe efektet e inflacionit, pa nënkuptuar një rritje automatike të çmimeve. One Albania SHA ka sqaruar se, pas vlerësimit të situatës dhe reagimeve të abonentëve, vendosi të aplikojë indeksimin vetëm për segmentin e abonentëve biznes, duke filluar nga 1 qershori 2024, në masën deri në 4.8%**,** bazuar në normën e inflacionit të publikuar nga INSTAT për muajin janar 2024, ndërsa indeksimi nuk është zbatuar për abonentët individualë gjatë periudhës objekt hetimi (1 janar 2022 – 18 nëntor 2025).

V. Rregullimi i Tregut

32. Sipas nenit 5 të Ligjit nr. 54/2024, një ndër objektivat rregullatorë të AKEP-it është promovimi i konkurrencës eficiente në ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, faciliteteve e shërbimeve shoqëruese të tyre, përfshirë konkurrencën efektive në infrastrukturën e komunikimeve elektronike, përmes investimeve ekonomikisht eficiente në infrastrukturën e re dhe atë ekzistuese.

33. Në përputhje me nenin 25 të Ligjit nr. 54/2024, AKEP-i bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës në çështje të interesit të përbashkët, në zbatim të legjislacionit në fuqi për konkurrencën në sektorin e komunikimeve elektronike. Në veçanti, në procesin e përcaktimit të tregjeve përkatëse dhe analizat e tyre, AKEP-i konsultohet dhe bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës.

34. Në nenin 142, Ligjit nr. 54/2024 përcaktohet se, ofruesit e shërbimit të aksesit në internet dhe ofruesit e shërbimeve të komunikimit ndërpersonal, duhet të publikojnë informacionin të disponueshëm për publikun i cili duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i lexueshëm nga pajisje kompjuterike, duke përfshirë publikimin në faqen e internetit të tij në një format të aksesueshëm për përdoruesit me aftësi të kufizuara, informacion i cili ndër të tjera duhet të përmbaje përshkrimin e shërbimeve të ofruara; tarifat e shërbimeve të ofruara; kushtet standarde të kontratës; të përfshijë mundësinë për të krahasuar çmimet, tarifat dhe cilësinë e performancës së shërbimit midis ofertave të disponueshme për përdoruesit fundorë etj.

35. Gjithashtu në vijim të nenit më sipër, pika 5, AKEP-i siguron që përdoruesit fundorë të kenë akses pa pagesë në të paktën një instrument të pavarur krahasimi, i cili u mundëson atyre krahasimin dhe vlerësimin e shërbimeve të ndryshme të aksesit në internet dhe shërbimeve të komunikimit ndërpersonal, të bazuar në numra të disponueshëm për publikun dhe, sipas rastit, shërbimin e komunikimit ndërpersonal, të disponueshëm për publikun, të pavarur nga numrat, në lidhje me:

a) çmimet dhe tarifat e shërbimeve të ofruara kundrejt pagesave monetare direkte, periodike ose për njësi të konsumuar;

b) cilësinë e performancës së shërbimit në rastet kur garantohet një nivel minimal i cilësisë së shërbimit ose kur sipërmarrësi ka detyrim të publikojë këtë informacion në përputhje me nenin 143 të këtij ligji.

36. Në bazë të nenit 8 të Rregullores nr. 27/2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”:

- sipërmarrësit janë të detyruar të paraqesin në AKEP informacionin mbi tarifat e shërbimeve, si dhe çdo ndryshim të tyre me arsyetimet mbeshtetese, jo më vonë se 15 ditë para hyrjes në fuqi të tarifave ose ndryshimeve të tyre.
- Ky informacion duhet të dërgohet në rrugë elektronike dhe/ose shkresore. Forma e dërgimit të të dhënave në rrugë elektronike do të jetë e disponueshme edhe në faqen e internetit të AKEP.
- AKEP-i publikon vlerësimin e përgjithshëm krahasues të tarifave aktuale sipas përcaktimeve të nenit 12 te kësaj rregulloreje.
- Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të njoftojnë, nëpërmjet mjeteve të informimit publik, çdo ndryshim në tarifat e shërbimeve, jo më pak se 7 ditë përpara hyrjes në fuqi të tyre ose të ndryshimeve dhe ky njoftim duhet të bëhet jo më pak se 3 ditë rresht;

- Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të publikojnë në faqen e tyre të internetit kushtet e përgjithshme të kontratave tip dhe t'ia paraqesin ato AKEP-it për vlerësim, të paktën, 15 ditë para publikimit sipas nenit 98 pika 5 te Ligjit.
- Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të njoftojnë pajtimtarët për cdo modifikim në kushtet e kontratave për jo më pak se 30 ditë përpara në përputhje me nenin 99 pika 3 të Ligjit.

37. AKEP, në faqen zyrtare publikon dokumentin "Vlerësimin e Përgjithshëm Krahasues të Tarifave Aktuale me titull "Tarifat e shërbimit nga rrjete celulare në Shqipëri".

    Sipas këtij dokumenti, në të jepen tabelat që i referohen dy operatorëve: Vodafone Albania; dhe One Albania, dhe që përmbajnë komponentët e mëposhtëm:

    1.Përmbledhje e paketave standarte;
    2.Tarifat standarte për shërbimin celular;
    3.Planet tarifore, paketat dhe ofertat.
    Këto tabela, ne lidhje me këto tre komponentë, në vlerësimin e AK nuk shoqërohen nga një analizë dhe vlerësim i përgjithshëm krahasues i tarifave aktuale, sipas përcaktimeve të nenit 8 dhe 12 të Rregullores nr. 27/2012" Mbi Publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike".

38. Po ashtu në nenin 12, të Rregullores nr. 27/2012 "Mbi publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike", citohet se: "AKEP, analizon dhe bën vlerësimin e përgjithshëm të tarifave aktuale, të disponueshme për publikun me qëllim publikimin e tyre në një seksion të vecantë në faqen elektronike të tij. Për publikimin e tarifave, AKEP udhëhiqet nga parimet themelore që janë: ligjshmëria, transparenca, mosdiskriminimi dhe profesionalizmi".

39. Për sa më sipër, AKEP në dokumentin e publikuar në faqen zyrtare, sipas vlerësimit të AK nuk ka realizuar një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm krahasues për ndryshimet e kryera në paketat standarde nga tre operatorë celularë në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

40. AKEP, ka sqaruar se mbledh, përpunon dhe publikon në mënyrë të vazhdueshme informacion mbi planet tarifore të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, informacion që i është përcjellë edhe Autoritetit të Konkurrencës. Gjithashtu, në vijim të rekomandimit të dhënë me Vendimin nr. 703/2020 të Komisionit të Konkurrencës, AKEP ka sqaruar se, në zbatim të nenit 12 të Rregullores nr. 27/2012, do të vijojë të publikojë informacion të përgjithshëm mbi tarifat dhe ndryshimet e tyre, me qëllim rritjen e transparencës dhe informimin e konsumatorëve. Megjithatë krahasimi i raporteve cilësi/çmim në tregun e shërbimeve celualare me pakicë, një treg që nuk rregullohet nga AKEP, mbetet jashtë detyrave të tij funksionale. Për më tepër krahasimi i planeve dhe

sugjerimi me karakter tregtar apo promovimin e planeve tarifore të operatorëve të caktuar, bie ndesh me përcaktimet e ligjit nr. 54/2024 dhe do të cënonte parimin themelor të neutralitetit dhe paanshmërisë së rregullatorit.

41. Referuar nenit 99, pika 1 të Ligjit nr. 54/2024, në përputhje me nenin 92 të këtij ligji, kur pas kryerjes së analizës së tregut AKEP-i evidenton se në treg mungon konkurrenca efektive, që nënkupton se sipërmarrësi i shpallur me fuqi të ndjeshme në treg ka aplikuar tarifa të larta të paarsyeshme ose tarifa të ulëta të paarsyeshme, në dëm të përdoruesve fundorë, AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin në lidhje me mbulimin e kostove dhe kontrollin e çmimeve, duke përfshirë detyrimet për orientimin e çmimeve drejt kostos, si dhe në lidhje me sistemin e mbajtjes së llogarive për ofrimin e llojeve të veçanta të aksesit ose interkoneksionit.

42. Neni 109, pika 1, pika 2 dhe 3 e Ligjit mr. 54/2024 "Kontrolli rregullator i shërbimeve të shitjes me pakicë", shpjegon se,

i. AKEP-i vendos detyrime rregullatore për sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në treg, në një treg përkatës me pakicë, në përputhje me këtë ligj kur:

a) nëse nga rezultatet e një analize tregu, të kryer në përputhje me nenin 90 të këtij ligji, AKEP-i përcakton se një treg i caktuar me pakicë, i identifikuar në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, nuk është në konkurrencë efektive;

b) AKEP-i arrin në përfundimin se detyrimet e vendosura sipas neneve 93 deri në 99 të këtij ligji, për tregun e lidhur me shumicë nuk çojnë në arritjen e objektivave të nenit 5 të këtij ligji.

ii. Detyrimet e vendosura sipas pikës 1 të këtij neni bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe janë proporcionale dhe të justifikuara për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji. Detyrimet e vendosura përfshijnë kërkesa që sipërmarrësit e identifikuar të mos ofrojnë çmime të larta, të cilat pengojnë hyrjen në treg ose kufizojnë konkurrencën, duke vendosur çmime grabitqare, të mos tregojnë preferenca të panevojshme ndaj përdoruesve fundorë specifikë ose shërbime paketë, në mënyrë të paarsyeshme. AKEP-i zbaton ndaj këtyre sipërmarrësve masat e duhura të kufirit të çmimit të shitjes me pakicë, masat për të kontrolluar tarifat individuale ose masat për orientimin e tarifave drejt kostove ose çmimeve në tregje të krahasueshme për të mbrojtur interesat e përdoruesve fundorë dhe për të nxitur konkurrencën efektive.

iii. AKEP-i siguron që, kur një sipërmarrës i nënshtrohet rregullimit të tarifave me pakicë ose rregullimeve të tjera përkatëse të shitjes me pakicë, zbatohen sistemet e nevojshme dhe të përshtatshme të kontabilitetit të kostos. AKEP-i specifikon formatin dhe metodologjinë e kontabilitetit që përdoret. Pajtueshmëria me sistemin e kontabilitetit të kostos verifikohet nga një organ i pavarur i kualifikuar. AKEP-i siguron që çdo vit të publikohet një deklaratë në lidhje me pajtueshmërinë.

43. Në lidhje me ndryshimet e kryera nga dy operatorët celularë, AKEP ka sqaruar se, në zbatim të Rregullores nr. 27, datë 21.09.2012, monitoron në mënyrë të vazhdueshme tregun e shërbimeve celulare, duke verifikuar publikimin e tarifave, ndryshimet e tyre dhe respektimin e detyrimeve për njoftim. Sipas AKEP-it, operatorët kanë njoftuar në afat hedhjen në treg të paketave të reja dhe ndryshimet tarifore. Në vlerësimin e saj mbi ecurinë e planeve tarifore për periudhën janar 2023 – shtator 2025, AKEP evidenton se, pas bashkimit të One me Albtelecom, tregu i shërbimeve celulare funksionon me dy operatorë, One Albania SHA dhe Vodafone Albania SHA, çka ka sjellë ndryshime edhe në strukturën e ofertave me pakicë. Sipas AKEP-it, gjatë kësaj periudhe është konstatuar reduktim i numrit dhe larmisë së paketave tarifore, veçanërisht në segmentin me parapagesë, i shoqëruar me rritje të çmimeve të shumicës së paketave standarde dhe, në disa raste, me shtim të njësive të komunikimit. Gjithashtu, AKEP vëren se paketat me çmime më të ulëta (500–600 lekë) nuk ofrohen më në pikat fizike të shitjes, por vetëm nëpërmjet kanaleve digjitale të operatorëve, ndërsa paketat standarde me çmime 1,000–1,100 lekë vijojnë të kenë përmbajtje të ulët interneti, duke orientuar konsumatorët drejt paketave me çmime më të larta. AKEP konstaton gjithashtu rritje të ndjeshme të të ardhurave me pakicë dhe të treguesit ARPU (Average Revenue Per User) gjatë viteve 2023–2024, tregues që lidhet me rritjen e çmimeve të paketave celulare. Në përfundim, AKEP thekson se, në zbatim të Ligjit nr. 54/2024, mund të ndërhyjë në rregullimin ex ante të tregut me pakicë vetëm nëse, pas analizës së tregut dhe testit të tre kritereve, konstatohet mungesa e konkurrencës efektive, ndërkohë që praktika e vendeve të Bashkimit Evropian nuk njeh rregullim ex ante të tregut me pakicë të shërbimeve celulare.

VI. Konkluzionet e hetimit

44. Tregu me pakicë i shërbimeve celulare në Republikën e Shqipërisë paraqitet si një treg duopolistik, ku ndërmarrjet Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA zotërojnë së bashku 100% të tregut.

45. Hetimi i thelluar ka evidentuar se kjo strukturë tregu ka qenë e qëndrueshme gjatë gjithë periudhës 1 janar 2022 – 18 nëntor 2025, duke u karakterizuar nga: nivele të larta të përqendrimit; barriera të konsiderueshme për hyrjen e operatorëve të rinj; nivel i kufizuar i presionit konkurrues ndërmjet dy ndërmarrjeve. Këto elemente, të marra së bashku, tregojnë se tregu me pakicë i shërbimeve celulare paraqet karakteristika të një tregu me strukturë të lartë përqendrimi dhe transparencë të lartë ndërmjet operatorëve, duke krijuar kushte që mund të favorizojnë sjellje të ngjashme tregtare dhe monitorim reciprok të sjelljes në treg. Megjithatë, analiza e kryer gjatë hetimit nuk provoi ekzistencën e një koordinimi apo praktike të bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve në kuptim të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.

46. Gjatë periudhës hetimore 1 janar 2022 – 18 nëntor 2025, hetimi i thelluar evidentoi se Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA kanë ndjekur sjellje tregtare me

karakteristika të ngjashme në lidhje me ofertat e shërbimeve celulare, përfshirë paketat me parapagesë, paketat me kontratë dhe shërbimet roaming.

47. Nga analiza rezultoi se: çmimet e paketave kanë pësuar rritje progresive dhe të përafërta në kohë; ndryshimet janë aplikuar në kategori të njëjta ose të ngjashme shërbimesh; janë konstatuar nivele të larta ngjashmërie në strukturën dhe përmbajtjen e ofertave. Këto elemente janë evidentuar në mënyrë të përsëritur gjatë periudhës hetimore dhe reflektojnë një nivel të lartë ngjashmërie në sjelljen tregtare të ndërmarrjeve në tregun përkatës. Megjithatë, analiza ekonomike dhe juridike e kryer gjatë hetimit nuk arriti të provojë se kjo sjellje ka qenë rezultat i një koordinimi apo praktike të bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve në kuptim të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.

48. Analiza kronologjike e ndryshimeve të çmimeve dhe strukturës së paketave tregon se, në disa raste, pas ndryshimeve të ndërmarra nga njëra ndërmarrje në lidhje me çmimet ose përmbajtjen e paketave, ndërmarrja tjetër ka reaguar brenda intervaleve të afërta kohore, duke aplikuar ndryshime të ngjashme në nivel çmimi dhe në strukturën e ofertës (minuta, internet, SMS, vlefshmëri, roaming etj.). Megjithatë, gjatë hetimit nuk u administruan prova të drejtpërdrejta apo të tërthorta që të provojnë ekzistencën e kontakteve, komunikimeve, shkëmbimit të informacionit sensitiv tregtar apo të një mekanizmi koordinues ndërmjet ndërmarrjeve në lidhje me përcaktimin e çmimeve apo strategjive tregtare. Në këto kushte, ngjashmëritë e konstatuara në reagimet tregtare të ndërmarrjeve janë vlerësuar në kontekstin e karakteristikave strukturore të tregut duopolistik dhe nivelit të lartë të transparencës së tij, ku operatorët monitorojnë vazhdimisht ofertat dhe sjelljen tregtare të njëri-tjetrit.

49. Hetimi evidentoi se ofertat e ndërmarrjeve paraqesin ngjashmëri në çmim dhe përmbajtje, përfshirë internetin, minutat kombëtare, vlefshmërinë e paketave dhe përfitimet roaming. Ky nivel i lartë ngjashmërie ndërmjet ofertave: kufizon nivelin e diferencimit të paketave në treg; reflekton një nivel të kufizuar të presionit konkurrues ndërmjet ndërmarrjeve; paraqet karakteristika tipike të një tregu me strukturë të lartë përqendrimi. Megjithatë, analiza ekonomike dhe juridike e kryer gjatë hetimit nuk provoi se kjo ngjashmëri e ofertave është rezultat i një koordinimi apo praktike të bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve.

50. Gjatë hetimit, ndërmarrjet nuk paraqitën një metodologji të plotë dhe të standardizuar të analizës kosto–çmim për çdo ndryshim tarifor të aplikuar gjatë periudhës hetimore. Në veçanti: nuk u administrua një analizë e detajuar kosto–çmim për çdo paketë; nuk u evidentuan elemente të plota të justifikimit ekonomik për çdo rritje çmimi; konstatuan mungesa në dokumentimin e metodologjisë së përllogaritjes së kostove. Pavarësisht, mungesa e një metodologjie të plotë ekonomike apo e dokumentimit të detajuar të kostove, në vetvete, nuk përbën provë të mjaftueshme për ekzistencën e një praktike të bashkërenduar në kuptim të Ligjit nr. 9121/2003.

51. Në tregje duopolistike me transparencë të lartë, si tregu me pakicë i shërbimeve celulare në Republikën e Shqipërisë, ndjekja e sjelljes së operatorëve konkurrentë dhe reagimi ndaj zhvillimeve të tregut mund të ndodhë si rezultat i përshtatjes së pavarur ndaj kushteve të tregut dhe monitorimit reciprok të operatorëve.

52. Nga analiza e paketave tarifore të ofruara nga Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA rezultoi se gjatë periudhës objekt hetimi ndërmarrjet nuk ofronin paketa të dedikuara për kategori të veçanta konsumatorësh, si pensionistët dhe studentët, me kushte tarifore të përshtatura me nevojat dhe aftësinë paguese të tyre. Gjithashtu, u konstatua një reduktim i ofertave me çmime të ulëta dhe orientimi i portofolit drejt paketave me çmime dhe përmbajtje më të larta, ndërkohë që paketat bazë me vlerë 500–600 lekë ofroheshin kryesisht nëpërmjet kanaleve digjitale. Këto zhvillime kufizojnë mundësitë e zgjedhjes për konsumatorët me konsum dhe aftësi paguese më të ulët, veçanërisht për kategoritë e pensionistëve dhe studentëve.

53. Nga analiza e termave dhe kushteve kontraktore të Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA rezultoi se kontratat e pajtimtarëve nuk parashikojnë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme disa të drejta dhe procedura me rëndësi për konsumatorët. Konkretisht, nuk pasqyrohet në mënyrë të shprehur e drejta e pajtimtarit, pas përfundimit të afatit kontraktor, për të kaluar lirisht nga një plan tarifor me çmim më të lartë në një plan tarifor me çmim më të ulët, sipas zgjedhjes së tij, pa penalitete apo kufizime të pajustifikuara. Gjithashtu, dispozitat që rregullojnë bartjen e numrit nuk përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme afatin brenda të cilit realizohet ky proces, si dhe kushtet dhe procedurat që duhet të ndiqen për përfundimin e tij. Mungesa e një informacioni të plotë dhe transparent në dokumentacionin kontraktor krijon pasiguri për pajtimtarët dhe mund të ndikojë në ushtrimin efektiv të të drejtave të tyre për zgjedhjen e planit tarifor dhe ndryshimin e operatorit.

54. Në përfundim, megjithëse gjatë periudhës 1 janar 2022 – 18 nëntor 2025 u evidentuan: sjellja e rritje të përafërta në kohë të çmimeve; reagime të ngjashme tregtare ndërmjet operatorëve; ngjashmëri në strukturën dhe përmbajtjen e ofertave; mungesë e një metodologjie të plotë dhe të standardizuar kosto–çmim, nuk provohet ekzistenca e një praktike të bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në kuptim të nenit 3, pika 4 dhe nenit 4, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003.

55. Për rrjedhojë, sjellja e konstatuar gjatë hetimit është vlerësuar si sjellje paralele tregtare në kushtet e një tregu me strukturë duopolistike dhe transparencë të lartë, e cila, në mungesë të provave mbi ekzistencën e koordinimit, komunikimit apo vullnetit të përbashkët ndërmjet ndërmarrjeve, nuk përbën praktikë të bashkërenduar apo abuzim me pozitën dominuese në kuptim të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 45, pika 2 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare me kushte dhe detyrime.

II. Detyrimin e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA për hartimin dhe zbatimin e një procedure të brendshme për miratimin e planeve tarifore për paketat me parapagesë, kontratë dhe shërbimet roaming, e cila:

a) Të marrë në konsideratë kostot e alokuara për shërbimin përkatës;
b) të përdoret si bazë për përcaktimin e çmimeve të reja ose rritjen e çmimeve ekzistuese;
c) të dokumentohet dhe të vihet në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës kurdo që do ti kërkohet nga ky i fundit. Ky dokumentacion ruhet nga ndërmarrjet Vodafone Albania sh.a dhe One Albania Sh.a për një periudhë 5 vjeçare ngas dita e krijimit të tij.

III. Detyrimin e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA që çdo ndryshim në çmim, përmbajtje, vlefshmëri të njoftohet individualisht tek pajtimtarët në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, jo më pak se 30 ditë përpara hyrjes në fuqi të ndryshimit, duke evidentuar konkretisht elementet që ndryshojnë.

IV. Detyrimin e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA që paketa më e lirë e shërbimeve celulare të ofrohet dhe të jetë realisht e disponueshme edhe në pikat fizike të shitjes, në kushte të barabarta informimi dhe aksesueshmërie me paketat e tjera të ofruara.

V. Detyrimin e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA që brenda afatit të monitorimit të zbatimit të këtij vendimi të përfshihet në kontratat e pajtimtarëve shprehimisht e drejta e pajtimtarit (pas përfundimit të kontratës) për të ndryshuar planin tarifor nga një plan me çmim më të lartë në një plan me çmim më të ulët sipas dëshirës së pajtimtarit nga secila prej paketave ekzistuese në atë moment (me kontratë ose parapagesë), pa vendosjen e penaliteteve, kufizimeve të pajustifikuara ose kushteve që pengojnë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.

VI. Detyrimin e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA që, brenda 90 ditëve, të hartojnë dhe të ofrojnë paketa të veçanta të shërbimeve celulare për grupmoshat a) pensionistë dhe; b) studentët 18 -23 vjeç, me kushte tarifore më të favorshme dhe të

përshtatura me nevojat dhe aftësinë paguese të këtyre kategorive të konsumatorëve, duke garantuar transparencë, aksesueshmëri dhe informim të plotë për përfitimin e këtyre paketave.

VII. Detyrimin e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA që, në hartimin dhe hedhjen në treg të paketave të reja, të garantojnë transparencë, diferencim real të ofertave dhe shmangien e praktikave që mund të kufizojnë zgjedhjen efektive të konsumatorëve në treg.

VIII. Detyrimin e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA që, për kontratat tip që hartohen, të marrin vlerësimin paraprak të Autoritetit të Konkurrencës, për të konfirmuar mungesën e klauzolave të padrejta tregtare.

IX. Detyrimin e ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA që, në kontratat e pajtimtarit, dispozitat që rregullojnë bartjen e numrit të jenë qartësisht të dallueshme për pajtimtarët dhe të përcaktohet qartë dhe në mënyrë të kuptueshme për pajtimtarin afati brenda të cilit realizohet ky proces dhe kushtet që duhet të plotësojë pajtimtari.

X. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrjet Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA, në zbatim të nenit 76, pika 1, gërma (a) të Ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.

XI. Monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve Vodafone Albania SHA dhe One Albania SHA në tregun me pakicë të shërbimeve celulare për një periudhë 1 vjeçare.

XII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1308, Datë 24.07.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT NËPËRMJET BLERJES SË 50% TË KUOTAVE, TË SHOQËRISË KS HUAYU ALUTECH GMBH NGA SHOQËRIA PORSCHE INVESTMENTS MANAGEMENT S.A."

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.07.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit nëpërmjet blerjes së 50% të kuotave, të shoqërisë KS HUAYU AluTech GmbH nga shoqëria Porsche Investments Management S.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit nëpërmjet blerjes së 50% të kuotave, të shoqërisë KS HUAYU AluTech GmbH nga shoqëria Porsche Investments Management S.A.",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit nëpërmjet blerjes së 50% të kuotave, të shoqërisë KS HUAYU AluTech GmbH nga shoqëria Porsche Investments Management S.A.
2. Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: Porsche Investments Management S.A** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut. Blerësi është degë 100% në pronësi të shoqërisë Dr. Ing.h.c.F. Porche Aktiengesellschaft, e cila është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, dhe me objekt aktiviteti: prodhimin dhe shitjen e automjeteve dhe motorëve të të gjitha llojeve, duke përfshirë avionët dhe mjetet ujore, si dhe pjesëve,

aksesorëve për produkte të tilla dhe të tjera teknike, etj. Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft është një filial i zotëruar në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft, shoqëria mëmë e Volkswagen Group.

4. *Grupi Volkswagen* është aktiv në tregun ndërkombëtar kryesisht në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.
5. Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.
   a. *Porsche Leasing SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari të qirasë financiare siç parashikohet nga dhe në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9696 datë 12.05.2005 "Për qiranë financiare", siç mund të ndryshohet herë pas here, agjent në sigurime dhe çdo veprimtari tjetër në lidhje me të, etj.
   b. *Porsche Albania SHPK* është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: shitje me shumicë dhe pakicë e automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.
6. **Shitësi: HUAYU Automotive Systems (Shanghai) Co., LTD** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Republikës Popullore të Kinës. Shitësi zotëron një aksion në shumën nominale prej 50% të kapitalit aksionar të regjistruar të shoqërisë target.
7. **Huadhënësi: HUAYU Automotive (Hong Kong) Co., LTD** është një shoqëri e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hong Kongut. Sipas Marrëveshjes së Huasë HASCO, huadhënësi i ka dhënë një hua me interes shoqërisë target në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshje.
8. **Shoqëria target: KS HUAYU AluTech GmbH** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë dhe me objekt aktiviteti si furnizues në industrinë automobilistike, i specializuar në derdhjen e aluminit të nivelit të lartë për komponentë të lehtë për automjete pasagjerësh dhe tregtare, si dhe një masë më të kufizuar për motoçikleta. Target ofron edhe shërbime konsulence dhe licencimi, duke ndarë njohuri teknike të proceseve me furnizues të tjerë dhe prodhues origjinalë (OEM).
9. Shoqëria target është aksionar i vetëm i filialeve të tij Werkzeugbau Walldürn Gesellschaft mit beschränkter Haftung dhe KS HUAYU Bearbeitungs GmbH.
10. Target nuk është i pranishëm në Shqipëri dhe nuk ka realizuar të ardhura në tregun shqiptar.

II. Përqendrimi

11. Referuar aktit noterial, datë [_____], blerësi Porsche Investments Management S.A i ka ofruar palës shitëse dhe palës huadhënëse të lidhin "Marrëveshje të blerjes së aksioneve",

lidhur, ndër të tjera, me shitjen dhe blerjen e një aksioni në shoqërinë target dhe me aktin noterial datë [_____], shitësi dhe huadhënësi e kanë pranuar këtë ofertë.

12. Me Aktin Noterial datë [_____], ndërmjet shoqërisë Porsche Investments Management S.A (blerësi), shoqërisë HUAYU Automotive Systems (Shanghai) Co., LTD (shitësi) dhe shoqërisë HUAYU Automotive (Hong Kong) Co.,LTD (huadhënësi) është finalizuar lidhja e "Marrëveshjes së blerjes së aksioneve", lidhur me shitblerjen e një aksioni (50%) të shoqërisë KS HUAYU AluTech GmbH. "Marrëveshja e blerjes së aksioneve", bashkëngjitur Ofertës, konsiderohet e lidhur me efekt të menjëhershëm.
13. Sipas Marrëveshjes së lidhur, shitësi synon të shesë dhe të transferojë aksionin e tij përkatës në shoqërinë target, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe blerësi pranon këtë shitje dhe transferim. Huadhënësi synon të marrë ripagesën e huasë së aksionarit dhënë shoqërisë target sipas kushteve të kësaj Marrëveshje.
14. Pala shitëse zotëron aksionin e shitur dhe shoqëria Rheinmetall Vermögensverwaltung 3 GmbH do të zotërojë aksionin tjetër me efekt nga data [_____], sipas një marrëveshje të caktuar për shitjen dhe transferimin e aksioneve të lidhur me datë [_____] me Rheinmetall Automotive AG.
15. Aplikantët, shoqëria Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft dhe shoqëria Rheinmetall Aktiengesellschaft do të zotërojnë indirekt, nëpërmjet kontrollit të përbashkët, shoqërinë target.
16. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit, nëpërmjet blerjes së 50% të kuotave, të shoqërisë KS HUAYU AluTech GmbH nga shoqëria Porsche Investments Management S.A., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

17. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu për prodhimin dhe furnizimin e komponentëve prej alumini për automjete pasagjerësh, automjete tregtare dhe motoçikleta, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
18. Transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit nëpërmjet blerjes së 50% të kuotave të shoqërisë KS HUAYU AluTech GmbH nga shoqëria Porsche Investments Management S.A, e cila kontrollohet tërësisht nga Dr. Ing. h.c. F. Porsche Aktiengesellschaft, një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, një prodhues makinash që specializohet në zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e makinave sportive me performancë të lartë, si dhe SUV-ve dhe sedanëve.
19. Porsche është një një filial i zotëruar në mënyrë indirekte nga Volkswagen Aktiengesellschaft, kompania mëmë e Volkswagen Group. Grupi Volkswagen operon në

Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK, aktiv në tregun e shitjes së makinave dhe ofrimin e qirasë financiare.

20. Shoqëria target KS HUAYU AluTech GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, furnizues në industrinë automobilistike, i specializuar në derdhjen e aluminit të nivelit të lartë për komponentë të lehtë për automjete pasagjerësh dhe tregtare, si dhe në një masë më të kufizuar për motoçikleta. Target nuk është i pranishëm dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri.
21. Transkasioni i njoftuar nuk krijon mbivendosje horizontale apo vertikale ndërmjet aktivitetit të Palëve apo ndryshime të strukturës së tregut në shtetin shqiptar, në lidhje me shitjen e komponentëve automobilistikë.
22. Sa më sipër, përqendrimi nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjellë ndryshim dhe nuk ka ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit nëpërmjet blerjes së 50% të kuotave, të shoqërisë KS HUAYU AluTech GmbH nga shoqëria Porsche Investments Management S.A..

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1309, Datë 24.07.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË ITALIA TRASPORTO AEREO S.P.A. NGA SHOQËRIA DEUTSCHE LUFTHANSA AKTIENGESELLSCHAFT"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.07.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Italia Trasporto Aereo S.p.A. nga shoqëria Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Italia Trasporto Aereo S.p.A. nga shoqëria Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Italia Trasporto Aereo S.p.A. nga shoqëria Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft.
2. Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft (Deutsche Lufthansa AG)** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit gjerman. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është trafiku ajror i brendshëm dhe ndërkombëtar dhe funksionimi i të gjitha aktiviteteve dhe objekteve që lidhen me aviacionin dhe promovimin e tij, si dhe veprimtarive të ngjashme ose të lidhura.

4. Deutsche Lufthansa AG është shoqëria mëmë e Grupit Lufthansa, i cili është prezent në Shqipëri nëpërmjet:
   a. ***Dega në Shqipëri e "Deutsche Lufthansa",*** degë e shoqërisë së huaj, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: të negociojë në emër të degës së shoqërisë në Shqipëri, të përfaqësojë degën në Shqipëri kundrejt palëve të treta, siç janë administrata publike dhe gjykatat, bankat dhe personat fizikë, të pranojë në emër të shoqërisë në Shqipëri njoftimet dhe vëniet në dijeni që kërkohen t'i dorëzohen shoqërisë etj.
   b. ***Dega në Shqipëri e Austrian Airlines AG,*** degë e shoqërisë së huaj, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: të negociojë në emër të degës së shoqërisë në Shqipëri, të përfaqësojë degën në Shqipëri kundrejt palëve të treta, siç janë administrata publike dhe gjykatat, bankat dhe personat fizikë, të pranojë në emër të shoqërisë në Shqipëri njoftimet dhe vëniet në dijeni që kërkohen t'i dorëzohen shoqërisë etj.
   c. ***Lufthansa Industry Solutions SHPK,*** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë është të angazhohet në zhvillimin e softuare-it dhe në veprimtari projekt, në veçanti projektim softuaresh, zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh softuare, testim softuaresh etj.
   d. ***Lufthansa Industry Solutions TECH SHPK,*** shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i aktivitetit të shoqërisë do të përfshijë: i) dizenjim softuare; ii) zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh softuare; iii) testim softuare; iv) dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë etj.
5. **Shitësi: Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Qeverisë Italiane (MEF).**
6. **Shoqëria target: Italia Trasporto Aereo S.p.A. (ITA)** është një shoqëri me kapital tërësisht shtetëror, e themeluar sipas legjislacionit italian, me objekt aktiviteti transport ajror pasagjerësh dhe mallrash.
7. Në vitin 2023, Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft bleu 41% të kapitalit aksionar të shoqërisë target dhe aktualisht Italia Trasporto Aereo S.p.A. zotërohet nga Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft në masën 41% dhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Qeverisë Italiane në masën 59%.
8. Transaksioni i mësipërm u autorizua nga Autoriteti i Konkurrencës me Vendimin Nr. 1029, datë 03 nëntor 2023 "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 41% të kuotave të shoqërisë Italia Trasporto Aereo S.p.A. nga shoqëria Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft".

II. Përqendrimi

9. [...].
10. Pjesa e mbetur e aksioneve të Klasës B, që përfaqësojnë 10% të kapitalit të ITA-s, do të mbetet në zotërim të MEF për një periudhë tjetër dyvjeçare, gjatë së cilës MEF do të mbajë një anëtar në bordin e ITA-s, pa të drejta vetoje.

11. Pas miratimit të transaksionit të propozuar nga autoritetet kompetente rregullatore dhe pas përfundimit të procedurave të transferimit të aksioneve, Deutsche Lufthansa AG do të zotërojë 90% të kapitalit të ITA-s, duke zotëruar kështu shumicën e aksioneve dhe si rrjedhojë kontrollin e vetëm të kësaj të fundit.
12. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Italia Trasporto Aereo S.p.A. nga shoqëria Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

13. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve të transportit ajror, (në shërbimin e transportit ajror të pasagjerëve dhe në transportin ajror të ngarkesave) dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
14. Sipas praktikave evropiane në trajtimin e transaksioneve të ngjashme në tregun e transportit ajror, rasteve të trajtuara nga Autoriteti i Konkurrencës, por edhe në rastin Case M.11071 - DEUTSCHE LUFTHANSA / MEF / ITA, tregu përkatës u nda në nëntregje, duke analizuar: shërbimet e transportit ajror të pasagjerëve dhe mallrave, sipas secilës linjë ajrore, itinerar, (origin–destination, O&D, ose city-pair), si një treg potencial të veçantë.
15. Kjo përqasje pasqyron perspektivën nga ana e kërkesës sipas së cilës konsumatorët udhëtojnë nga një qytet (ose zonë shërbimi – catchment area) origjine në një qytet (ose zonë shërbimi – catchment area) destinacioni, dhe ky kombinim nuk është i zëvendësueshëm me një rrugë tjetër pikë origjine/pikë destinacioni (O&D). Sipas këtij vlerësimi, nga këndvështrimi i konsumatorit, çdo kombinim pikë origjine – pikë destinacioni (O&D) konsiderohet si treg më vete.

Shërbimin e transportit ajror të udhëtarëve.

16. Referuar të statistikave të publikuara nga Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza" u evidentua se gjatë vitit 2025, në këtë aeroport kanë operuar 31 linja ajrore, ku një pjesë e tyre operojnë për periudha të caktuara (sezonale) ose janë charter. Ofruesi më i madh i shërbimit është linja ajrore Wizz Air me xx% të tregut të transportit të udhëtarëve, linja ajrore Ryanair me xx% të tregut, Lufthansa me xx% të tregut, linja ajrore ITA me xx% të tregut, Austrian Airlines me xx%, Eurowings me xx% dhe Swiss Air Lines me xx% të tregut për vitin 2025.
17. Në Grupin Lufthansa bëjnë pjesë shoqëritë e fluturimit Austrian Airlines, Eurowings dhe Swiss Air Lines dhe pjesa e tregut për shërbimin e transportit ajror të pasagjerëve për vitin 2025 për Grupin Lufthansa është xx%. Me blerjen e xx% të kuotave të ITA në vitin 2023, Lufthansa mori kontrollin e përbashkët të ITA. Pjesa e tregut të Grupit Lufthansa bashkë me ITA shkon në xx% të numrit të udhëtarëve gjatë vitit 2025.

18. Transaksioni i përftimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Italia Trasporto Aereo S.p.A. nga shoqëria Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft ka për pasojë vetën ndryshimin e kuotave brenda një shoqërie, i cili nuk ndikon në strukturën e tregut të shërbimit të transportit ajror në Shqipëri.
19. Mbështetur në përcaktimin e tregut përkatës, si dhe referuar të dhënave të TIA-s dhe palës njoftuese, kemi evidentuar se shoqëritë e Grupit Lufthansa dhe ITA ofrojnë fluturime direkte (vajtje-ardhje), në linjat Tiranë - Frankfurt, Tiranë - Munich, Tiranë - Dyseldorf, Tiranë - Këln, Tiranë - Stutgart, Tiranë - Zyrih, Tiranë - Vienë dhe Tiranë - Romë.
20. Nga sa publikohet në faqen zyrtare të TIA-s konstatohet se pjesa më e madhe e këtyre destinacioneve janë të aksesueshëm edhe nga shoqëritë Wizz Air dhe Ryanair, duke ofruar konkurrencë mes ofruesve të shërbimit.
21. Nga sa më sipër, Transaksioni i Propozuar nuk krijon mbivendosje të drejtpërdrejta midis aktivitetit të palëve në tregun e shërbimit të transportit ajror të pasagjerëve në Shqipëri. Duke patur në konsideratë pjesën e tregut që palët në transaksion zotërojnë sipas numrit të pasagjerëve, transaksioni nuk ngre shqetësime serioze për konkurrencën.

Shërbimin e transportit ajror të mallrave.

22. Transporti ajror i ngarkesave ofrohet nga linjat ajrore ose distributorët kryesisht për shpërndarësit e ngarkesave ajrore.
23. Sipas informacionit të depozituar nga pala njoftuese, evidentohet se DLH është aktive në këtë shërbim nëpërmjet shoqërisë së saj, plotësisht të kontrolluar, Lufthansa Cargo AG, e cila e ofron këtë shërbim nëpërmjet flotës së saj me avionë ngarkesash, avionësh çarter dhe në barkun e avionëve të flotës së Lufthansës për shërbime të programuara. Gjithashtu ky shërbim ofrohet nga shoqëritë e tjera të grupit.
24. ITA është aktive nëpërmjet shërbimit të saj ITA Airways Cargo, nëpërmjet të cilit shoqëria shfrytëzon kapacitetin e barkut të avionëve të saj dhe operon në disa fluturime vetëm për transport ngarkesash.
25. Mbi të njëjtin arsyetim sikurse tek tregu i transportit ajror të pasagjereve, edhe në këtë shërbim nuk konstatohet mbivendosje tregjesh përkatës të produktit.
26. Transaksioni i propozuar nuk krijon një mbivendosje horizontale të palëve në ofrimin e shërbimit të transportit ajror dhe ndryshimi nga kontroll i përbashkët në kontroll të vetëm nuk ndikon në treg dhe nuk sjell mbivendosje të reja ose të rëndësishme. Për rrjedhojë, situata konkurruese në linjat përkatëse mbetet në thelb e njëjtë.
27. Si përfundim, ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Italia Trasporto Aereo S.p.A. nga shoqëria Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1310, Datë 24.07.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË NESKO METAL SANAYI VE TICARET ANONIM ŞIRKETI NGA SHOQËRIA EKIN MADEN TICARET VE SANAYI ANONIM ŞIRKETI."

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.07.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të shoqërisë Nesko Metal Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi Anonim Şirketi.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit të shoqërisë Nesko Metal Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi Anonim Şirketi",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit të shoqërisë Nesko Metal Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi Anonim Şirketi.
2. Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: Ekin Maden Ticaret ve Sanayi Anonim Şirketi** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit turk, lider në sektorin e metaleve dhe mineraleve në Turqi.
4. Ekin Maden Ticaret ve Sanayi Anonim Şirketi nuk ka asnjë filial të regjistruar në Shqipëri, por ka realizuar xhiro.
5. **Shitësit:**

- **JIANGXI COPPER INTERNATIONAL İSTAMBUL MADENCİLİK YATIRIMLARI ANONİM ŞİRKETİ** është një shoqëri e themeluar në Republikën Popullore të Kinës, me objekt kryesor zhvillimin e burimeve minerare të metaleve me ngjyra dhe investimi, si dhe operimin në zinxhirin e vlerës së metaleve me ngjyra, e cila zotëron 48% të aksioneve të shoqërisë target.
- **CRM International (Beijing) Co., Ltd.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në Republikën Popullore të Kinës, me objekti kryesor ofrimin e shërbimeve të integrimit të zinxhirit të furnizimit, si dhe tregtinë dhe zhvillimin e burimeve të lëndëve të para me ngjyra dhe jometalike, e cila zotëron 1% të aksioneve të shoqërisë target.
- **Beijing Metal Challenge Global Trading Co., Ltd.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në Republikën Popullore të Kinës, me objekt veprimtarie zhvillimin, promovimin e tregtisë së metaleve me ngjyra dhe lëndëve të para në Kinë, e cila zotëron 1% të aksioneve të shoqërisë target.

6. **Shoqëria target: Nesko Metal Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Turqisë. Qëllimi i shoqërisë është prodhimi, tregtia me shumicë, importi, eksporti i çdo lloj minerali dhe metali, minerali dhe koncentrati mineralesh, pjesëmarrja në tendera brenda dhe jashtë vendit etj. Nga sa deklaron pala njoftuese, përpara transaksionit, shoqëria target kontrollohet përbashkërisht nga pala blerëse dhe palët shitëse.
7. Nesko Metal Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi zotëron plotësisht në Shqipëri shoqërinë BERALB SHA, shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me aktivitet në fushën minerare. Shoqëria ka të drejtë të importojë lirisht dhe pas asnjë kufizim pajisje, makineri dhe materiale të tjera të cilat mund të nevojiten gjatë procesit të prodhimit, duke përfshirë eksplozive dhe materiale të tjera për përdorimin e duhur të tyre.

II. Përqendrimi

8. Më datë [_____], ndërmjet shoqërisë Ekin Maden Ticaret ve Sanayi Anonim Şirketi (blerësi) dhe shoqërive JIANGXI COPPER INTERNATIONAL İSTAMBUL MADENCİLİK YATIRIMLARI ANONİM ŞİRKETİ, CRM International (Beijing) Co., Ltd. dhe Beijing Metal Challenge Global Trading Co., Ltd. (shitësit) është nënshkruar "Marrëveshje për Shitblerjen e Aksioneve".
9. Në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj marrëveshje, blerësi do të blejë nga shitësit Aksionet e Shitjes, të cilat përbëjnë XX% të të gjithë kapitalit aksionar të shoqërisë target.
10. Pas përfundimit të transaksionit të propozuar, blerësi do të zotërojë XX% të aksioneve dhe do të ushtrojë kontroll të vetëm mbi shoqërinë target Nesko Metal Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi dhe në mënyrë të tërthortë mbi shoqërinë BERALB SHA.
11. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë Nesko Metal Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi Anonim Şirketi, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III.Analiza e konkurrencës

12. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i nxjerrjes/pasurimit të mineralit të bakrit dhe prodhimi i koncentratit të tij si dhe tregtimi (eksporti) i bakrit dhe nënprodukteve të tij dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
13. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë Nesko Metal Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi Anonim Şirketi.
14. Shoqëria Nesko Metal Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi ka filialin e saj në Shqipëri shoqërinë BERALB SHA, [_____].
15. Përqendrimi konsiston në kalimin nga kontrolli i përbashkët në kontroll të vetëm mbi Nesko Metal Sanayi ve Ticaret A.S. dhe në mënyrë të tërthortë mbi BERALB SHA, pa sjell ndryshime në aktivitetin ekonomik të shoqërisë apo në strukturën e tregut përkatës. Pjesa e tregut dhe pozita e shoqërisë BERALB SHA në tregun përkatës do të mbetet e pandryshuar pas realizimit të transaksionit.
16. Ky transaksion nuk do të ketë për pasojë hyrjen e asnjë operator i ri ekonomik dhe asnjë aktivitet ekonomik ekzistues nuk largohet prej tij. Shoqëria BERALB SHA do të vazhdojë të ushtrojë të njëjtën veprimtari në sektorin e nxjerrjes, pasurimit dhe eksportit të koncentratit të bakrit.
17. Transaksioni i propozuar nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjell ndryshim dhe nuk ka ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të shoqërisë Nesko Metal Sanayi ve Ticaret Anonim Şirketi nga shoqëria Ekin Maden Ticaret ve Sanayi Anonim Şirketi.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1311, Datë 17.08.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ENSO HYDRO ENERGJI SHPK NGA SHOQËRIA ALBASTEEL PCP SHPK"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit për përftimin e kontrollit të shoqërisë ENSO HYDRO ENERGJI SHPK nga shoqëria ALBASTEEL PCP SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit të shoqërisë ENSO HYDRO ENERGJI SHPK nga shoqëria ALBASTEEL PCP SHPK.",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përftimit të kontrollit të shoqërisë ENSO HYDRO ENERGJI SHPK nga shoqëria ALBASTEEL PCP SHPK.
2. Referuar dokumentit "Marrëveshja për blerjen e aksioneve", nënshkruar më datë [...], palët në marrëveshje janë:
3. **Pala blerëse: ALBASTEEL PCP SHPK** është një shoqëri shqiptare, me objekt aktiviteti: projektim, prodhim, zbatim dhe rikonstruksion të godinave industriale dhe civile, urave me konstruksion metalik, mbikalime për kalimtarë dhe hekurudhore, ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje, ndërtime hidroteknike, sisteme hidraulike dhe impiante për bonifikime, struktura metalike për tunele, sillosa metalike, kulla uji metalike etj. Sipas

formularit të njoftimit të përqendrimit, fusha e veprimtarisë së shoqërisë është prodhimi dhe shitja e tubave të çelikut.

4. Shoqëria ALBSTEEL PCP SHPK zotërohet 100% nga Z. K. Zeytinoglu, person fizik, i cili zotëron 50% të kuotave në shoqërinë ERDY ENERGY SHPK.
5. Shoqëria ERDY ENERGY SHPK është e licencuar nga ERE për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC i Kalis, në përroin e Shmilit, Qarku Elbasan dhe realizon të ardhura nga shitja e energjisë elektrike.
6. **Pala shitëse: enso HYDRO GmbH** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar rregullisht ne Regjistrin Tregtar Austriak, me seli dhe adresë biznesi Raaaba-Grambach, Austri. Shitësi është zotërues i vetëm i kapitalit të shoqërisë ENSO HYDRO ERERGJI SHPK.
7. **Shoqëria target: ENSO HYDRO ENERGJI SHPK** është një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar dhe me objekt aktiviteti: zhvillim, ndërtim, operim, blerja dhe shitja e hidrocentraleve, prodhimi i energjisë elektrike dhe shitja e energjisë elektrike tek konsumatorët ose tregtarët e shitjes me shumicë. Gjithashtu, kjo shoqëri mund të hyjë në çdo transaksion që ajo e gjykon të nevojshëm ose të përshtatshëm me qëllim përmbushjen e objektit të veprimtarisë së saj.
8. Shoqëria shërben si një Shoqëri Holding, e cila zotëron 100% shoqëritë koncesionare MATI HYDROPOWER SHPK dhe LENGARICA & ENERGY SHPK.

   a. **MATI HYDROPOWER SHPK** është një shoqëri shqiptare me objekt aktiviteti: ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Mati1, Mati2, dhe Mati3, tek Autoritetet Kontraktuese, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, në zbatim të kontratës së koncesionit me Autoritetin Kontraktues.

   Sipas pasqyrave financiare të audituara për vitin 2025 të shoqërisë MATI HYDROPOWER SHPK, evidentohet se hidrocentrali është në fazën e ndërtimit dhe nuk ka filluar ende prodhimin e energjisë elektrike.

   b. **LENGARICA & ENERGY SHPK** është një shoqëri shqiptare me objekt aktiviteti: zhvillim, ndërtim, operim, blerja dhe shitja e hidrocentraleve, prodhimi i energjisë elektrike dhe shitja e energjisë elektrike tek konsumatorët ose tregtarët e shitjes me shumicë. Gjithashtu, kjo shoqëri mund të hyjë në çdo transaksion që ajo e gjykon të nevojshëm ose të përshtatshëm me qëllim përmbushjen e objektit të veprimtarisë së saj.

   Sipas pasqyrave financiare te vitit 2025, shënime shpjeguese, konstatohet se shoqëria realizon të ardhura nga shitja e energjisë elektrike.

II. Përqendrimi

9. Më datë [...] është lidhur "Marrëveshja për blerjen e aksioneve" ndërmjet shoqërisë ALBASTEEL PCP SHPK (blerësi) dhe shoqërisë enso Hydro GmbH (shitësi), me qëllim shitjen e kapitalit aksionar të shoqërisë ENSO HYDRO SHPK, i përfaqësuar nga një aksion i vetëm, në vlerën 2,612,737 lekë.

10. Në kushtet paraprake të mbylljes, palët kanë parashikuar: rritjen e kapitalit të shoqërisë; rregullimin e marrëdhënies kontraktuale me punonjësit drejtues të shoqërisë; njoftimin e shitjes së aksioneve tek ERE; njoftimin pranë Autoritetit te Konkurrencës dhe dorëzimin e Garancisë Bankare.
11. Nga verifikimi i ekstraktit të shoqërisë ENSO HYDRO SHPK pranë QKB, u konstatua se palët kanë regjistruar ndryshimin e kontrollit të shoqërisë target, e cila aktualisht kontrollohet 100% nga shoqëria blerëse ALBASTEEL PCP SHPK.
12. Transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë ENSO HYDRO SHPK nga shoqëria ALBASTEEL PCP SHPK, transaksion, i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

13. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", aktivitetit të palëve pjesëmarrëse, si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike. Për analizimin e këtij rasti, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
14. Transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë ENSO HYDRO ENERGJI SHPK nga shoqëria ALBASTEEL PCP SHPK.
15. Referuar aktivitetit ekonomik të shoqërisë target dhe shoqërive të kontrolluara prej saj, konstatuam se shoqëritë ushtrojnë aktivitet në tregun e prodhimit të energjisë elektrike dhe janë mbajtëse të kontratave të koncesionit në këtë sektor. Transaksioni i njoftuar krijon një mbivendosje horizontale të aktivitetit të ndërmarrjeve pjesëmarrëse në përqendrim.
16. Shoqëria target, ENSO HYDRO ENERGJI SHPK zotëron 100% shoqëritë koncesionare MATI HYDROPOWER SHPK dhe LENGARICA & ENERGY SHPK.
17. Shoqëria MATI HYDROPOWER SHPK është mbajtëse e kontratës së koncesionit për ndërtimin operimin dhe shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentrale të ndërtuara në lumin Mat, por shoqëria ende nuk ka filluar prodhimin e energjisë elektrike.
18. Shoqëria LENGARICA & ENERGY SHPK është mbajtëse e kontratës së koncesionit për ndërtimin operimin dhe shitjen e energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentral të ndërtuar në lumin Langaricë. Sipas Raportit të ERE për vitin 2024, shoqëria ka prodhuar dhe tregtuar energji elektrike, duke zotëruar rreth xx% të tregut të prodhimit të energjisë në Sistemin Energjetik Shqiptar.
19. Shoqëria blerëse është zotëruese e shoqërisë ERDY ENERGY SHPK, e cila operon në tregun e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet Hec Kalis. Gjatë vitit 2024 shoqëria ka prodhuar dhe tregtuar energji elektrike duke zotëruar rreth xx% të prodhimit total të energjisë në Republikën e Shqipërisë.
20. Referuar aktivitetit tregtar të shoqërive si dhe pjesës së tregut që kanë zotëruar në vitin 2024, konstatohet se pjesa e kombinuar e tregut të shoqërisë LENGARICA & ENERGY SHPK dhe ERDY ENERGY SHPK është xx% sipas sasisë së energjisë së prodhuar dhe tregtuar

në rrjetin e shpërndarjes dhe xx% e tregut sipas sasisë totale të prodhuar në sistemin energjetik shqiptar, pa ngritur shqetësime të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në treg.

21. Sipas deklaratës së palës njoftuese, transaksioni është vlerësuar si diversifikim i portofolit të biznesit të ALBSTEEL PCP SHPK duke investuar në fushën e energjisë së rinovueshme. Struktura e shoqërisë target dhe gjendja e shoqërive të kontrolluara prej saj, rezultatet financiare të viteve të fundit dhe pritshmëritë e gjenerimit të të ardhurave në të ardhmen, garantojnë për blerësin një kthim investimi të kënaqshëm.
22. Transaksioni i njoftuar aktualisht nuk krijon shqetësime për konkurrencën për shkak të krijimit apo forcimit të pozitës dominuese në treg. Prezenca në tregun e prodhimit të energjisë elektrike e shoqërive të zotëruara nga shoqëria ALBASTEEL PCP SHPK dhe ENSO HYDRO ENERGJI SHPK nuk sjell shqetësime për konkurrencën, pasi pjesa e tregut që ato zotërojnë, në tregun përkatës, është shumë e vogël.
23. Gjithsesi, tregu i prodhimit dhe shitjes së energjisë elektrike është një treg i rregulluar ku mekanizmi konkurrues i çmimit përcaktohet nga rregullatori. Ky transaksion nuk sjell shqetësime për konkurrencën në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin për përftimin e kontrollit të shoqërisë ENSO HYDRO ENERGJI SHPK nga shoqëria ALBASTEEL PCP SHPK.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1312, Datë 17.08.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRIVE MARKETING INVESTMENT GROUP CR LLC, MARKETING INVESTMENT GROUP CZECH S.R.O., MIG MARKETING INVESTMENT GROUP RO SRL, MARKETING INVESTMENT GROUP BULGARIA EOOD, MARKETING INVESTMENT GROUP SLOVAKIA S.R.O., MARKETING INVESTMENT GROUP SR D.O.O., MARKETING INVESTMENT GROUP HUNGARY KFT. NGA SHOQËRITË E GRUPIT SPORT VISION"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërive Marketing Investment Group CR LLC, MARKETING INVESTMENT GROUP CZECH s.r.o., MIG MARKETING INVESTMENT GROUP RO SRL, Marketing Investment Group Bulgaria EOOD, MARKETING INVESTMENT GROUP SLOVAKIA s.r.o., Marketing Investment Group SR d.o.o., Marketing Investment Group Hungary Kft. nga shoqëritë e Grupit Sport Vision.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit të vetëm të shoqërive Marketing Investment Group CR LLC, MARKETING INVESTMENT GROUP CZECH s.r.o., MIG MARKETING INVESTMENT GROUP RO SRL, Marketing Investment Group Bulgaria EOOD, MARKETING INVESTMENT GROUP SLOVAKIA s.r.o., Marketing Investment Group SR d.o.o., Marketing Investment Group Hungary Kft. nga shoqëritë e Grupit Sport Vision",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e propozuar lidhur me ndryshimin e kontrollit të drejtpërdrejtë dhe/ ose të tërthortë të shoqërive target; Marketing Investment Group CR LLC, Marketing Investment Group CZECH s.r.o., MIG Marketing Investment Group RO SRL, Marketing Investment Group Bulgaria EOOD, Marketing Investment Group SLOVAKIA s.r.o., Marketing Investment Group SR d.o.o. Beograd, Marketing Investment Group Hungary Kft.
2. Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi 1: BDS SPORT CR Ltd.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me objekt aktiviteti: blerje dhe shitje mallrash, ndërmjetësim tregtar në tregjet vendase dhe të huaja, prodhim i produkteve tekstile; prodhim i produkteve të lëkurës etj.
4. **Blerësi 2: BDS SPORT CZ s.r.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Çekisë, me objekt aktiviteti: prodhimi, tregtia me shumicë dhe pakicë, ndërmjetësim në tregti dhe shërbime, prodhimi i tekstileve, produkteve tekstile, veshjeve dhe aksesorëve të ndryshëm etj.
5. **Blerësi 3: BDS RO SPORT S.R.L** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Rumanisë, me objekt aktivitet kryesor tregtia me pakicë e pajisjeve sportive.
6. **Blerësi 4: BDS SPORT BG EAD** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Bullgarisë, me objekt aktiviteti: tregtia me shumicë dhe pakicë vendase dhe e huaj e mallrave ushqimore dhe industriale, turizimi vendas dhe ndërkombëtar / pas licencës/, biznes hotelier, hapja dhe menaxhimi i lokaleve të ushqimit, shërbime reklamimi etj.
7. **Blerësi 5: BDS SPORT SK s.r.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Sllovakisë, me objekt aktiviteti: blerja e mallrave me qëllim shitjen e tyre te konsumatori përfundimtar, aktivitet ndërmjetësues brenda fushëveprimit të tregtisë së lirë, aktivitet reklamues dhe promovues brenda fushëveprimit të tregtisë së lirë etj.
8. **Blerësi 6: BDS RS. DOO BEOGRAD** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Serbisë, me objekt aktiviteti: tregti me shumicë e veshjeve dhe këpucëve.
9. **Blerësi 7: BDS SPORT HU Kft.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, me objekt aktiviteti kryesor tregtia me pakicë e veshjeve.
10. Shoqëritë blerëse BDS janë pjesë e Grupit Sport Vision, një nga kompanitë kryesore të shitjes me pakicë të artikujve sportivë në Evropën Juglindore, e cila operon në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë IN SPORT SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: import-eksport dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i mallrave kryesisht artikujve sportive dhe artikujve industrialë, impianteve, mjeteve makinerive, pjesëve të këmbimit, elektroshtëpiake, elektronike, elektrike etj.

11. **Shitësi : Marketing Investment Group S.A.** është një shoqëri aksionare në Poloni, me seli qendrore në Krakov. Ajo operon në sektorin e Dyqaneve të Këpucëve dhe është anëtar i grupit JD Sport Fashion Plc. Pala njoftuese deklaron se shitësi ka aktualisht në pronësi të plotë shoqëritë target.
12. **Shoqëria target 1: Marketing Investment Group CR LLC** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me objekt aktiviteti: blerje dhe shitje mallrash, kryerje ndërmjetësimi tregtar në tregjet vendase dhe të huaja, etj.
13. **Shoqëria target 2: MARKETING INVESTMENT GROUP CZECH s.r.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Çekisë, me objekt aktiviteti: prodhim, tregti me shumicë dhe pakicë, magazinim, paketim, transport mallrash, reklamim etj.
14. **Shoqëria target 3: MIG MARKETING INVESTMENT GROUP RO SRL** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit rumun, me objekt aktiviteti kryesor tregti me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure.
15. **Shoqëria target 4: Marketing Investment Group Bulgaria EOOD** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Bullgarisë, me objekt aktiviteti: tregtia, shitja me pakicë e këpucëve dhe veshjeve në dyqan dhe shitjet online, marketing, reklamim etj.
16. **Shoqëria target 5: MARKETING INVESTMENT GROUP SLOVAKIA s.r.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Sllovakisë, me objekt aktiviteti: blerja e mallrave me qëllim shitjen e tyre te konsumatori përfundimtar (pakicë) ose te operatorë të tjerë tregtarë (shumicë), aktivitet ndërmjetësues në fushën e tregtisë etj.
17. **Shoqëria target 6: Marketing Investment Group SR d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Serbisë, me objekt aktiviteti tregti me pakicë i këpucëve dhe artikujve prej lëkure në dyqane të specializuara.
18. **Shoqëria target 7: Marketing Investment Group Hungary Kft.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, me objekt aktiviteti kryesor tregtia me pakicë e këpucëve dhe artikujve prej lëkure.
19. Shoqëritë Target nuk kanë filiale dhe nuk kanë realizuar xhiro në Shqipëri.

II. Përqendrimi

20. Më datë [...] 2026, ndërmjet palëve, BDS SPORT CR Ltd., BDS SPORT CZ s.r.o., BDS RO SPORT S.R.L., BDS SPORT BG EAD, BDS SPORT SK s.r.o., BDS RS. DOO BEOGRAD, BDS SPORT HU Kft. (blerësit) dhe Marketing Investment Group S.A. (shitësi), janë lidhur "Marrëveshje Blerje Aksionesh", individuale, për blerjen e gjithë kapitalit aksionar të emetuar të shoqërive Marketing Investment Group CR LLC, MARKETING INVESTMENT GROUP CZECH s.r.o., MIG MARKETING INVESTMENT GROUP RO SRL, Marketing Investment Group Bulgaria EOOD, MARKETING INVESTMENT GROUP SLOVAKIA s.r.o., Marketing Investment Group SR d.o.o., Marketing Investment Group Hungary Kft.

21. Marrëveshjet kanë të njëjtën përmbajtje dhe objekt, shitjen e të gjitha aksioneve të shitjes nga shitësi tek blerësi në përputhje me kushtet e Marrëveshjes, që përfaqëson 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë target, në pronësi vetëm të shitësit dhe të rënë dakord të shitet nga shitësi tek blerësi sipas Marrëveshjes.
22. Shitësi është anëtar i grupit JD Sport Fashion Plc dhe ka marrë vendim strategjik për të konvertuar biznesin e tij në Evropën Qendrore dhe Lindore (me përjashtim të Polonisë) nga një model operimi në pronësi të korporatës në një model operimi me ekskuzivitet (franchise). Transaksionet në këto Marrëveshje janë të strukturuara për të lehtësuar një konvertim të tillë.
23. [...]
24. [..]
25. [...].
26. Palët gjithashtu kanë rënë dakord që blerësi do të blejë nga shitësi në përfundim disa Inventarë dhe Asete të Qëndrueshme, për të siguruar vazhdimësitë e pandërprera të shoqërive të grupit të blerësve, përfshirë shoqërinë target përkatëse, sipas modelit të dakorduar të operimit të bazuar në franchising.
27. Sipas nenit 2 "Shitja e Aksioneve të Shitjes", të Marrëveshjes, Shitësi pranon të shesë i lirë nga çdo pengesë dhe blerësi të blejë të drejtat që lidhen me aksionet e shitjes, duke përfshirë të gjithë dividentët e paguar në ose pas datës së përfundimit, për shpërblimin dhe sipas kushteve të kësaj Marrëveshje dhe në varësi të përmbushje së kushteve.
28. Titulli ligjor i Aksioneve të shitjes do ti kalojë blerësit në përfundim pas (i) nënshkrimit të Aktit të Transferimit; (ii) regjistrimit të blerësit si mbajtës i aksioneve të shitjes në librin e aksioneve të shoqërisë; (iii) kreditimit të llogarisë bankare të shitësit me shpërblimin paraprak dhe (iv) dorëzimit të Aktit të Transferimit dhe dokumentacionit shoqërues për transferim të vlefshëm të aksioneve në regjistrin përkatës.
29. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërive Marketing Investment Group CR d.o.o. LLC, MARKETING INVESTMENT GROUP CZECH s.r.o., MIG MARKETING INVESTMENT GROUP RO SRL, Marketing Investment Group Bulgaria EOOD, MARKETING INVESTMENT GROUP SLOVAKIA s.r.o., Marketing Investment Group SR d.o.o.Beograd, Marketing Investment Group Hungary Kft. nga shoqëritë BDS SPORT CR Ltd., BDS SPORT CZ s.r.o., BDS RO SPORT S.R.L., BDS SPORT BG EAD, BDS SPORT SK s.r.o., BDS RS. DOO BEOGRAD, BDS SPORT HU Kft. (shoqëri të grupit Sport Vision), duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

II. Analiza e konkurrencës

30. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i furnizimit me pakicë të mallrave sportivë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të

mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

31. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërive Marketing Investment Group CR d.o.o. LLC, MARKETING INVESTMENT GROUP CZECH s.r.o., MIG MARKETING INVESTMENT GROUP RO SRL, Marketing Investment Group Bulgaria EOOD, MARKETING INVESTMENT GROUP SLOVAKIA s.r.o., Marketing Investment Group SR d.o.o., Marketing Investment Group Hungary Kft. nga shoqëritë BDS SPORT CR Ltd., BDS SPORT CZ s.r.o., BDS RO SPORT S.R.L., BDS SPORT BG EAD, BDS SPORT SK s.r.o., BDS RS. DOO BEOGRAD, BDS SPORT HU Kft.
32. Grupi i shoqërive blerëse BDS operon në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë IN SPORT SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: import-eksport dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i mallrave kryesisht artikujve sportive dhe artikujve industrialë, impianteve, mjeteve makinerive, pjesëve të këmbimit, elektroshtëpiake, elektronike, elektrike etj.
33. Shoqëritë Target nuk janë prezente dhe nuk realizojnë xhiro në Shqipëri.
34. Transaksioni i Propozuar nuk sjell mbivendosje të aktivitetit të palëve pjesëmarrëse në transaksion dhe për pasojë nuk ndryshon strukturën e tregut përkatës në Shqipëri. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërive Marketing Investment Group CR LLC, MARKETING INVESTMENT GROUP CZECH s.r.o., MIG MARKETING INVESTMENT GROUP RO SRL, Marketing Investment Group Bulgaria EOOD, MARKETING INVESTMENT GROUP SLOVAKIA s.r.o., Marketing Investment Group SR d.o.o., Marketing Investment Group Hungary Kft. nga shoqëritë e Grupit Sport Vision.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1313, Datë 17.08.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TH. NITSIAKOS AVEE PTINOTROFIKES EPICHEIRISEIS NGA SHOQËRITË PERUTNINA PTUJ D.O.O. DHE FAMILJA NITSIAKOS"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis nga shoqëritë PERUTNINA PTUJ d.o.o. dhe Familja Nitsiakos.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis nga shoqëritë PERUTNINA PTUJ d.o.o. dhe Familja Nitsiakos.",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis nga shoqëritë PERUTNINA PTUJ d.o.o. dhe Familja Nitsiakos.
2. Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: PERUTNINA PTUJ d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Sllovenisë, e cila ushtron aktivitetin e saj në shitjen e mishit të shpendëve dhe produkteve të përpunuara nga mishi i shpendëve, kryesisht në tregjet vendase, duke shfrytëzuar kapacitetet e veta prodhuese. PERUTNINA PTUJ d.o.o. zotërohet plotësisht nga MHP SE, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Qipros,

shoqëria mëmë e Grupit MHP, e cila zhvillon aktivitete të përpunimit të mishit dhe kapacitetet prodhuese të tij sigurojnë mbulimin e të gjithë ciklit të prodhimit të pulës.

4. Në Shqipëri, Grupi MHP është aktiv përmes shitjeve të kryera nga PERUTNINA PTUJ d.o.o., MHP Trade B.V. dhe MHP Agros – S LLC.
5. Grupi MHP është prezent në Shqipëri përmes filialit të tij, Perutnina Ptuj Albania SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti investim në industrinë e shpendëve nëpërmjet blerjes së shoqërive, biznesit dhe aseteve.
6. Aktualisht Perutnina Ptuj Albania SHPK nuk është plotësisht operative dhe ka shifra të ulëta të ardhurash. Pjesa më e madhe e xhiros së Grupit në Shqipëri gjenerohet nga shoqëritë e tjera të grupit përmes distributorëve lokalë.
7. **Shitësit:**
   - **ISTOS TOXOTIS SINGLE MEMBER P.C.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm, e themeluar sipas legjislacionit të Greqisë, kapitali i së cilës zotërohet 100% nga z. Konstantinos Nitsiakos.
   - **ORITHEN MELORIA SINGLE MEMBER P.C.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm, e themeluar sipas legjislacionit të Greqisë, kapitali i së cilës zotërohet 100% nga znj. Angeliki Nitsiakou.
   - **MRE MARITHE SINGLE MEMBER P.C.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm, e themeluar sipas legjislacionit të Greqisë, kapitali i së cilës zotërohet 100% nga znj. Eleni Nitsiakou.
   - **ISTOS TOXOTIS Ltd.** një shoqëri qipriote me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm, kapitali i së cilës zotërohet 100% nga z. Konstantinos Nitsiakos.
   - **ORITHEM MELORIA LIMITED,** një shoqëri qipriote me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm, kapitali i së cilës zotërohet 100% nga znj. Angeliki Nitsiakou.
   - **MPE MARITHE Ltd.,** një shoqëri qipriote me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm, kapitali i së cilës zotërohet 100% nga znj. Eleni Nitsiakou.
8. Familja Nitsiakos përfaqëson një entitet të vetëm ekonomik të përbërë nga tre persona fizikë z. Konstantinos Nitsiakos, znj. Angeliki Nitsiakou dhe znj. Eleni Nitsiakou, të cilët ushtrojnë ndikim vendimtar dhe kontroll përmes subjekteve të mësipërme, nëpërmjet të drejtave të tyre të pronësisë dhe drejtimit. Shoqëritë e mësipërme nuk ushtrojnë asnjë aktivitet tjetër biznesi, përveçse veprojnë si entitete mbajtëse (holding) për target.
9. **Shoqëria target: Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Greqisë, (së bashku me filialet Grupi Nitsiakos ose Grupi target). Grupi Nitsiakos është një grup grek aktiv në sektorin e mishit dhe shpendëve.
10. Në Shqipëri, Grupi Nitsiakos nuk ushtron aktivitet nëpërmjet ndonjë filiali apo dege, por ka gjeneruar të ardhura për vitin 2025, nga shitja e një gamë të gjerë produktesh mishi.

11. Përpara implementimit të transaksionit të propozuar, shoqëria target kontrollohej bashkërisht në masën xx% nga secila prej shoqërive ISTOS TOXOTIS SINGLE MEMBER P.C., ORITHEN MELORIA SINGLE MEMBER P.C., MRE MARITHE SINGLE MEMBER P.C., ISTOS TOXOTIS Ltd. ORITHEM MELORIA LIMITED dhe MPE MARITHE Ltd.

II. **Përqendrimi**

12. Më datë [..], shoqëritë PERUTNINA PTUJ d.o.o. (blerësi) dhe z. Konstantinos Nitsiakos, znj. Angeliki Nitsiakou dhe znj. Eleni Nitsiakou, të cilët veprojnë nëpërmjet shoqërive të zotëruara prej tyre (shitësit), kanë nënshkruar "Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e xx% të aksioneve të kapitalit aksionar të emetuar të Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis".
13. Referuar kësaj marrëveshje, transaksioni i propozuar do të realizohet përmes një blerjeje e cila do të kalojë përmes tre fazave të njëpasnjëshme, si më poshtë:
    - [...];
    - [...];
    - [...].
14. Në Mbylljen të Fazës 1, shoqëria target do të jetë pronarja e vetme ligjore dhe përfituese e çdo shoqërie bijë (dege) sipas parashikimeve në kontratë.
15. Tre subjektet shitëse qipriote, ISTOS TOXOTIS Ltd., ORITHEM MELORIA LIMITED dhe MPE MARITHE Ltd. do të transferojnë plotësisht pjesëmarrjen e tyre aksionare në target.
16. Pas implementimit të transaksionit të propozuar, PERUTNINA PTUJ d.o.o. do të zotërojë xx% të aksioneve në target, ndërsa pjesëmarrja e mbetur prej xx% në kapitalin aksionar të target do të zotërohet ekskluzivisht nga tre subjektet shitëse greke, përkatësisht ISTOS TOXOTIS SINGLE MEMBER P.C., ORITHEN MELORIA SINGLE MEMBER P.C. dhe MRE MARITHE SINGLE MEMBER P.C., ku secila prej tyre do të zotërojë xx% të aksioneve të target.
17. Nga sa deklaron pala njoftuese, target do të zotërohet përfundimisht me kontroll të përbashkët nga Grupi MHP, nëpërmjet PERUTNINA PTUJ d.o.o., si dhe nga familja Nitsiakos (nëpërmjet ISTOS TOXOTIS SINGLE MEMBER P.C., ORITHEN MELORIA SINGLE MEMBER P.C. dhe MRE MARITHE SINGLE MEMBER P.C.). [...].
18. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis nga shoqëritë PERUTNINA PTUJ d.o.o. dhe Familja Nitsiakos, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

19. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes me shumicë i mishit të shpendëve, por duke qenë se

transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

20. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis nga shoqëritë PERUTNINA PTUJ d.o.o. dhe Familja Nitsiakos.
21. Shoqëria PERUTNINA PTUJ d.o.o. zotërohet plotësisht nga MHP SE. Në Shqipëri, Grupi MHP është aktiv përmes shitjeve të kryera nga PERUTNINA PTUJ d.o.o. në tregun e mishit të papërpunuar të shpendëve dhe atë të mishit të përpunuar të shpendëve.
22. Grupi MHP është prezent në Shqipëri përmes filialit të tij, Perutnina Ptuj Albania SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti investim në industrinë e shpendëve nëpërmjet blerjes së shoqërive, biznesit dhe aseteve. Megjithatë kjo shoqëri nuk është plotësisht operative dhe ka shifra të ulëta shitjesh, vetëm nga ofrimi i shërbimeve.
23. Grupi Nitsiakos është kryesisht aktiv në Greqi, me aktivitete më të kufizuara në disa juridiksione të Ballkanit dhe vende të tjera evropiane.
24. Në Shqipëri, Grupi Nitsiakos nuk ushtron aktivitet nëpërmjet ndonjë filiali apo dege, por ka gjeneruar të ardhura për vitin 2025 nëpërmjet shitjes se një gamë të gjerë produktesh mishi.
25. Aktivitetet e palëve në këtë transaksion krijojnë mbivendosje horizontale të kufizuara. Në veçanti: -në tregun e prodhimit dhe shitjes së mishit të papërpunuar të shpendëve, çdo mbivendosje është de minimis, pasi MHP nuk është aktive në treg, ndërsa target zotëron afërsisht xx%; -në tregun e prodhimit dhe shitjes së mishit të përpunuar të shpendëve, MHP është aktive me një pjesë tregu afërsisht prej xx%, ndërsa target zotëron afërsisht xx%.
26. Transaksioni i propozuar krijon mbivendosje horizontale të kufizuara midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, por për shkak të pjesës së vogël të tregut që zënë palët e përfshira në këtë transaksion, nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Th. Nitsiakos AVEE Ptinotrofikes Epicheiriseis nga shoqëritë PERUTNINA PTUJ d.o.o. dhe Familja Nitsiakos.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1314, Datë 17.08.2026

"PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE I-FIRE SHPK DHE P.F. AERD MAHMUTAJ"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE:

1. Agjencia e Prokurimit Publik (APP), nëpërmjet shkresës nr. 7291/1/4 prot., datë 16.12.2025, (protokolluar pranë AK me nr. 1133 prot., datë 24.12.2025), ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës një rast mbi dyshimin për marrëveshje në oferta ndërmjet operatorëve ekonomikë i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj.

2. APP, nëpërmjet kësaj shkrese, ka bërë me dije se pranë saj është depozituar ankesa e ndërmarrjes Victoria-Al SHPK, me objekt kërkesën për nisjen e procedurave administrative ndaj operatorëve ekonomikë i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj, duke pretenduar se operatori ekonomik Aerd Mahmutaj P.F. përdor të dhëna identifikuese që i përkasin ndërmarrjes i-Fire" SHPK (emër, adresë, e-mail, kontakte). Sipas ankuesit, dy operatorët ekonomikë ushtrojnë aktivitet si një njësi ekonomike e vetme. Personi fizik Aerd Mahmutaj përdor logon dhe etiketat e produkteve të ndërmarrjes i-Fire SHPK.

3. APP shprehet se, si pjesë e dosjes së Dokumenteve Standarde të Tenderit, një ndër dokumentet që u kërkohet operatorëve ekonomikë të paraqesin për tu kualifikuar në një procedure prokurimi është edhe "Deklarata për dorëzimin e ofertave të pavarura". Qëllimi i dorëzimit të kësaj deklarate është identifikimi i marrëveshjeve të fshehta në ofertë, pasi

këto marrëveshje të fshehta sjellin pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg dhe përbejnë shkelje të rendë të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

4. Nisur nga parimi i nxitjes së konkurrencës, nëpërmjet operatorëve ekonomikë, si dhe në kuadër te Memorandumit të bashkëpunimit nr. 28/2 prot., datë 02.04.2019 të nënshkruar me Autoritetin e Konkurrencës, APP ka përcjellë këtë rast për të vijuar më tej hetimin sa i takon kësaj çështjeje.

5. Në kuadër të vlerësimit të rastit, Autoriteti i Konkurrencës ka administruar informacion dhe dokumentacion nga APP, KESH SHA dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, lidhur me procedurat e prokurimit ku kanë marrë pjesë ndërmarrjet i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj gjatë periudhës 11 janar 2024 deri në 31 dhjetor 2025.

6. Nga verifikimi i ekstrakteve të QKB-së rezulton se Z. Aerd Mahmutaj ka qenë administrator i ndërmarrjes i-Fire SHPK deri më 04.01.2018 dhe ortak me 10% të kuotave deri më 04.01.2023. Gjithashtu, konstatohet se numri i celularit të Z. Aerd Mahmutaj vijon të figurojë në ekstraktin tregtar të ndërmarrjes i-Fire SHPK.

7. Nga analiza e të dhënave të depozituara nga APP rezulton se, ndërmarrja i-Fire SHPK ka marrë pjesë në 120 procedura prokurimi gjatë periudhës 11.01.2024–31.12.2025, ndërsa P.F. Aerd Mahmutaj ka marrë pjesë në 115 procedura prokurimi. Nga këto procedura, të dy subjektet kanë marrë pjesë njëkohësisht në 13 procedura prokurimi.

8. Nga analiza e procedurave të përbashkëta rezulton se në vitin 2025 ndërmarrja i-Fire SHPK nuk ka marrë pjesë në asnjë procedurë prokurimi, ndërkohë që P.F. Aerd Mahmutaj ka rritur ndjeshëm pjesëmarrjen e tij në procedurat e prokurimit public (102 procedura).

9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të tenderit të administruar nga KESH dhe Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike nuk rezulton të jenë konstatuar në ofertat e paraqitura elementë identifikues të ndërmarrjes i-Fire SHPK, si emri, adresa, e-maili, numrat e kontaktit apo logoja e saj. Është konstatuar se këto të dhëna gjenden në formularët e ankesave të depozituara pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe jo në dokumentacionin e ofertave të procedurave të prokurimit.

10. Pavarësisht sa më sipër, nga vlerësimi në tërësi i të dhënave të administruara, përfshirë lidhjet e mëparshme ndërmjet ndërmarrjeve, të dhënat e përbashkëta të kontaktit dhe mënyrën e pjesëmarrjes së tyre në procedurat e prokurimit publik, u evidentuan elemente që kërkonin verifikim të mëtejshëm në kuadër të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe Udhëzimit "Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike".

11. Për sa më sipër, u ngritën dyshime të arsyeshme se sjellja e ndërmarrjeve i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj mund të përmbante elemente të një sjelljeje antikonkurruese, e cila mund të sillte kufizimin, shtrembërimin apo pengimin e konkurrencës në kuptim të nenit 4, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës". Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", me Vendimin nr. 1303, datë 26.06.2026, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj, për periudhën kohore nga 11 janar 2024 deri më 26 qershor 2026.

12. Në zbatim të Vendimit nr. 1303, datë 26.06.2026 si dhe Autorizimit nr. 522/3, datë 26.06.2026, "Autorizim inspektorësh", grupet e inspektimit, gjatë periudhës së hetimit paraprak, kryen inspektimet e nevojshme pranë adresave të deklaruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) nga ndërmarrjet i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj.

13. Gjatë inspektimit të kryer pranë ndërmarrjes i-Fire SHPK u gjetën komunikime elektronike (e-mail) ndërmjet ndërmarrjeve i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj, të cilat lidhen me procedura të prokurimit publik. Përmbajtja e këtyre komunikimeve përbën indicie që shtojnë dyshimet për ekzistencën e një bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve nën hetim, i cili mund të ketë ndikuar në mënyrën e pjesëmarrjes dhe paraqitjes së ofertave në procedurat e prokurimit publik, në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

14. Gjithashtu, sipas deklarimeve të pasqyruara në procesverbalet përkatëse të inspektimit, rezulton se përfaqësuesit e ndërmarrjeve njihen me njëri-tjetrin, kanë pasur marrëdhënie biznesi dhe, në raste të caktuara, kanë shkëmbyer informacione lidhur me oferta dhe/ose pjesëmarrjen në procedura të prokurimit publik.

15. Gjatë verifikimeve për ushtrimin e inspektimit pranë ndërmarrjes P.F. Aerd Mahmutaj, grupi i inspektimit nuk arriti të identifikonte një ambient fizik ku kjo ndërmarrje ushtronte veprimtarinë në adresën e deklaruar në QKB. Nëpërmjet komunikimit me numrat e telefonit të deklaruar në të dhënat e QKB-së, inspektorët u orientuan drejt ambienteve të ndërmarrjes i-Fire SHPK. Përfaqësuesi i kësaj të fundit deklaroi se z. Aerd Mahmutaj nuk dispononte një ambient fizik ku ushtronte veprimtarinë. Nga verifikimet e kryera rezultoi gjithashtu se një prej numrave të telefonit të deklaruar në QKB për P.F. Aerd Mahmutaj i përkiste përfaqësuesit të ndërmarrjes i-Fire SHPK. Në këto rrethana, për efekt njoftimi dhe nisur nga marrëdhënia e njohjes dhe bashkëpunimit ndërmjet palëve, Vendimi nr. 1303, datë 26.06.2026, "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj", iu dorëzua përfaqësuesit të ndërmarrjes i-Fire SHPK.

16. Në vijim, inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës u paraqitën edhe pranë adresës së re të deklaruar në QKB nga ndërmarrja P.F. Aerd Mahmutaj. Për shkak të pamundësisë për të identifikuar vendndodhjen e saktë të subjektit, u kontaktua z. Aerd Mahmutaj, i cili deklaroi se nuk ndodhej në Tiranë dhe se pika fizike ku ushtronte veprimtarinë ishte mbyllur. Më pas, inspektorët u kontaktuan nga një numër telefoni, i cili, pas verifikimit, rezultoi se i përkiste ndërmarrjes i-Fire SHPK, si dhe nga një numër tjetër që i përkiste zyrës së kontabilitetit të P.F. Aerd Mahmutaj. Në të dyja komunikimet, inspektorëve të Autoritetit të Konkurrencës iu kërkua që Vendimi nr. 1303, datë 26.06.2026, t'i dorëzohej ndërmarrjes P.F. Aerd Mahmutaj nëpërmjet ambienteve të ndërmarrjes i-Fire SHPK.

17. Komunikimet elektronike të evidentuara gjatë inspektimit lidhur me procedurat e prokurimit publik, deklarimet për ekzistencën e marrëdhënieve të biznesit dhe shkëmbimin e informacioneve mbi ofertat dhe/ose pjesëmarrjen në procedura prokurimi, si dhe elementet e konstatuara gjatë inspektimit lidhur me kontaktet dhe adresën e ushtrimit të veprimtarisë së P.F. Aerd Mahmutaj, përbëjnë indicie që kërkojnë një analizë dhe hetim të mëtejshëm të sjelljes së ndërmarrjeve i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj.

18. Si përfundim, sa më sipër, bazuar në nenin 4, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet që kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe në Udhëzimin "Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike", nga të dhënat dhe indiciet e administruara gjatë procedurës së hetimit paraprak ngrihen dyshime të arsyeshme se sjellja e ndërmarrjeve i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj në procedurat e prokurimit publik mund të përmbajë elemente të një marrëveshjeje të ndaluar në oferta midis tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

VENDOSI:

I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve i-Fire SHPK dhe P.F. Aerd Mahmutaj.

II. Hetimi i thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 11.01.2024 deri në 17.08.2026.

III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1315, Datë 17.08.2026

"PËR VENDOSJEN E GJOBËS PERIODIKE DITORE NDAJ NDËRMARRJES TIRANA ADMINISTRIM SHPK PËR MOSPËRMBUSHJEN E DETYRIMIT PËR DEPOZITIMIN E INFORMACIONIT NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1304, DATË 26.06.2026"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Vendosja e gjobës periodike ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK për për mospërmbushjen e detyrimit për depozitimin e informacionit në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1304, datë 26.06.2026.

Baza Ligjore: Neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 76, pika 1, germa (ç) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE :

1. Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Vendimit nr. 1145/2024, me shkresën nr. 97 prot., datë 29.01.2026, me objekt "Mbi zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1145, datë 27.12.2024", i është drejtuar ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK duke kërkuar informacion lidhur me zbatimin e pikës (IV), (V) dhe (VI) të VKK nr. 1145, datë 27.12.2024, me afat për kthim - përgjigje brenda datës 23.01.2026. Ndërmarrja Tirana Administrim SHPK nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion të Autoritetit të Konkurrencës.

2. Në vijim, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr. 97/1 prot., datë 17.03.2026, me objekt "Rikujtesë mbi kërkesën për informacion të AK nr. 97 prot., datë 29.01.2026", i është drejtuar sërish ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK duke i kërkuar vënien në dispozicion të të dhënave të mësipërme brenda datës 27.03.2026. Edhe ndaj kësaj kërkese, ndërmarrja nuk ka paraqitur asnjë përgjigje.

3. Gjithashtu, me email-in e datës 30.03.2026 (protokolluar me nr. 97/2 prot., datë 30.03.2026), me objekt "Kërkesë për dhënie informacioni dhe rikujtesë mbi detyrimet

ligjore", Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës i është drejtuar përsëri ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK, duke kërkuar sigurimin e informacionit të kërkuar brenda datës 03.04.2026. Edhe kësaj here, ndërmarrja nuk i është përgjigjur kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës.

4. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1287, datë 23.04.2026 "Kërkesë për sigurimin e informacionit nga ana e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK", vendosi:

I. T'i kërkojë ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin lidhur me zbatimin e pikës (IV), (V) dhe (VI) të Vendimit nr. 1145, datë 27.12.2024, "Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë gjobitjen dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK".

II. Informacioni i përcaktuar në pikën I, duhet të dorëzohet brenda afatit 15 ditor nga dita që ky vendim është njoftuar.

III. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në dispozitivin I dhe II të këtij vendimi, ndërmarrja Tirana Administrim SHPK ndëshkohet me gjobë në masën deri në 1 për qind të xhiros totale të vitit paraardhës financiar në zbatim të nenit 73, pika 1, germa (a) të Ligjit nr. 9121/2003.

5. Ndërmarrja Tirana Administrim SHPK nëpërmjet shkresës nr. 97/6 prot., datë 14.05.2026 "Plotësim i kërkesave të Vendimit të Komisionit të Konkurrenës nr. 1287, datë 23.04.2026, njoftuar me shkresën nr.prot. 97/5 datë 24.04.2026, me lëndë "Dërgim Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr. 1287, datë 23.04.2026", si dhe kërkesë për pezullimin e procedurës së monitorimit deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë", ka bërë me dije si vijon:

- Ka rishikuar kontratat me operatorët e internetit për t'i përshtatur me kërkesat e Autoritetit të Konkurrencës dhe pretendon se nuk kufizon aksesin e asnjë operatori interneti në pallatet/rezidencat që administron;
- Ka bashkëngjitur si provë një kontratë me operatorin Albanian Satellite Communications SHPK;
- Pretendon se pikat IV, V dhe VI të Vendimit nr. 1145/2024 nuk janë ende të formës së prerë, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është ankimuar në Apel;
- Argumenton se, për sa kohë çështja është ende në shqyrtim gjyqësor, Autoriteti nuk mund të kërkojë zbatimin e masave korrigjuese për këto pika;

- Kërkon zyrtarisht pezullimin e procedurës së monitorimit të zbatimit të pikave IV, V dhe VI deri në përfundimin e procesit në Gjykatën Administrative të Apelit me vendim të formës së prerë;
- Shton se zbatimi i menjëhershëm i këtyre pikave do të cenonte sigurinë juridike, të drejtën për mbrojtje gjyqësore efektive dhe parimin e proporcionalitetit.

6. Informacioni i paraqitur nga ndërmarrja Tirana Administrim SHPK nuk provon përmbushjen e detyrimit për rishikimin e kontratave, pasi edhe sipas VKK nr. 1145/2024 janë evidentuar, konkretisht: (i) aplikim i tarifave të ndryshme dhe diskriminuese ndaj operatorëve të internetit për akses në të njëjtën infrastrukturë fizike në komplekse të ndryshme rezidenciale; (ii) parashikimi në kontrata i detyrimit për heqjen e infrastrukturës fizike në përfundim të kontratës, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi; (iii) përcaktimi i operatorëve preferencialë për t'u referuar tek banorët e rezidencave, duke krijuar trajtim të pabarabartë ndërmjet operatorëve. Këto sjellje janë vlerësuar nga Komisioni i Konkurrencës si sjellje që përbëjn abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 9, pika 2 germa (c) dhe (ç) të Ligjit nr. 9121/2003.

7. Pretendimet e paraqitura nga ndërmarrja Tirana Administrim SHPK lidhur me pezullimin e procedurës së monitorimit dhe moszbatimin e pikave IV, V dhe VI të Vendimit nr. 1145, datë 27.12.2024, nuk qëndrojnë, pasi nga dokumentacioni i paraqitur nuk rezulton të jetë marrë nga Gjykata Administrative e Apelit një masë sigurimi apo një vendim i ndërmjetëm që të pezullojë efektet juridike të kushteve dhe detyrimeve të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës.

8. Në këto kushte, vetëm ekzistenca e një procesi gjyqësor apo ushtrimi i së drejtës së ankimit nuk sjell automatikisht pezullimin e efekteve juridike të vendimit administrativ, për aq kohë sa nuk ekziston një vendim gjyqësor i shprehur që të disponojë pezullimin e zbatimit të tij. Për rrjedhojë, Autoriteti i Konkurrencës vijon të ushtrojë kompetencat e tij ligjore për monitorimin dhe vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjes në zbatim të Ligjit nr. 9121/2003.

9. Vlerësohet gjithashtu se informacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nga ndërmarrja Tirana Administrim SHPK nuk është i plotë dhe nuk provon përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në Vendimin nr. 1145, datë 27.12.2024, pasi nuk evidentohet rishikimi i plotë të gjitha kontratave të konstatuara si në kundërshtim të nenit 9, germa (c) dhe (ç) të Ligjit nr. 9121/2003.

10. Për më tepër, kërkesa për informacion dhe procedura e monitorimit kanë karakter administrativ dhe synojnë verifikimin e respektimit të kushteve dhe detyrimeve të vendosura nga Komisioni i Konkurrencës, pa paragjykuar shqyrtimin gjyqësor të çështjes në themel.

11. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1304, datë 26.06.2026, "Gjobitjen e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK për mos dhënien e informacionit në zbatim të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1287, datë 23.04.2026 "Kërkesë për sigurimin e informacionit nga ana e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK"", vendosi:

I. Gjobitjen e ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK në masën 1% të xhiros totale të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 177,650 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) Lekë.

II. Ndërmarrja Tirana Administrim SHPK duhet të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës informacionin lidhur me zbatimin e pikës (IV), (V) dhe (VI) të Vendimit nr. 1145, datë 27.12.2024, "Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ofrimit dhe aksesit të shërbimit të internetit ndaj ndërmarrjeve të administrimit dhe ndërmarrjeve të internetit në rezidencat e banimit ku këto ndërmarrje ushtrojnë veprimtarinë gjobitjen dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK", brenda afatit 15 ditor nga dita që ky vendim është njoftuar.

III. Në rast të mos përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në pikën II të këtij vendimi, ndërmarrja Tirana Administrim SHPK ndëshkohet me gjobë periodike ditore jo më shumë se 5 për qind të xhiros mesatare ditore në vitin financiar paraardhës në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (ç) të Ligjit nr. 9121/2003.

12. Sa më sipër, ndërmarrja nuk ka depozituar informacionin e kërkuar në zbatim të pikës II të Vendimit nr. 1304, datë 26.06.2026.

13. Në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (ç) të Ligjit nr. 9121/2003, Komisioni vendos mbi ndërmarrjet gjoba në pagesa periodike ditore jo më shumë se 5 për qind të xhiros mesatare ditore në vitin financiar paraardhës, e cila llogaritet nga data e marrjes së vendimit, në mënyrë që ato të japin të dhëna të plota dhe të sakta, të cilat Komisioni i ka kërkuar me vendim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 76, pika 1, germa (ç), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

I. Vendosjen ndaj ndërmarrjes Tirana Administrim SHPK të një gjobe periodike ditore në masën 1% të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (ç), të ligjit nr. 9121/2003, për çdo ditë vonesë, duke filluar nga data e

njoftimit të këtij vendimi dhe deri në përmbushjen e plotë të detyrimit të përcaktuar në pikën II të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1304, datë 26.06.2026.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1316, Datë 17.08.2026

MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT
"MBI PËRKUFIZIMIN E TREGUT PËRKATËS."

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi miratimin e udhëzimit "Mbi përkufizimin e tregut përkatës".

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

- Draft - udhëzimit "Mbi përkufizimin e tregut përkatës".

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzimit "Mbi përkufizimin e tregut përkatës", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Udhëzimi Nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", shfuqizohet.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1317, Datë 17.08.2026

MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT
"PËR IMUNITETIN NGA GJOBAT DHE LEHTËSIMIN E GJOBAVE NË RASTET E MARRËVESHJEVE TË NDALUARA."

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi miratimin e udhëzimit "Për imunitetin nga gjobat dhe lehtësimin e gjobave në rastet e marrëveshjeve të ndaluara."

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

- Draft - udhëzimit "Për imunitetin nga gjobat dhe lehtësimin e gjobave në rastet e marrëveshjeve të ndaluara".

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzimit "Për imunitetin nga gjobat dhe lehtësimin e gjobave në rastet e marrëveshjeve të ndaluara", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Rregullorja nr. 382, datë 17.11.2015 "Për miratimin e "Programit të Lehtësimit nga Gjobat" dhe "Formulari i Aplikimit për Lehtësimin nga Gjobat", shfuqizohet.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1318, Datë 17.08.2026

MBI MIRATIMIN E UDHËZIMIT
"PËR VLERËSIMIN E MARRËVESHJEVE TË NËNKONTRAKTIMIT NË LIDHJE ME NENIN 4 TË LIGJIT 9121/2003".

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.08.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi miratimin e udhëzimit "Për vlerësimin e marrëveshjeve të nënkontraktimit në lidhje me nenin 4 të ligjit 9121/2003".

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

- Draft - udhëzimit "Për vlerësimin e marrëveshjeve të nënkontraktimit në lidhje me nenin 4 të ligjit 9121/2003".

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzimit "Udhëzimin "Për vlerësimin e marrëveshjeve të nënkontraktimit në lidhje me nenin 4 të ligjit 9121/2003", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1320, Datë 11.09.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË BUSINESS LEASE HUNGARY KFT. NGA SHOQËRIA MERKANTIL BANK ZRT."

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të shoqërisë Business Lease Hungary Kft. nga shoqëria Merkantil Bank Zrt..

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit të shoqërisë Business Lease Hungary Kft. nga shoqëria Merkantil Bank Zrt.",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit të shoqërisë Business Lease Hungary Kft. nga shoqëria Merkantil Bank Zrt.
2. Referuar dokumentit "Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e të gjitha aksioneve të emetuara në Business Lease Hungary Kft.", nënshkruar më datë 03 korrik 2026, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: Merkantil Váltó és Vagyonbefektető Zártkörűen Működő Részvénytársaság (Merkantil Bank Zrt.)** është një shoqëri aksionere, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, me veprimtari kryesore: dhënie e kredive të tjera dhe ndërmjetësime të tjera monetare, leasing financiar, veprimtari agjentë brokeri dhe në fushën e sigurimeve. Që nga viti 1996, Merkantil Bank është anëtare e Grupit OTP (Hungari).
4. Grupi OTP është aktiv në Shqipëri në tregun e ofrimit të shërbimeve bankare, nëpërmjet shoqërisë Banka OTP Albania SHA, një shoqëri aksionare, themeluar sipas legjislacionit

shqiptar, me objekt aktiviteti: a) Pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet, b) dhënie huash të të gjitha llojeve duke përfshirë kredi konsumatorësh dhe kredi hipotekore, c) faktoring dhe financim të transaksioneve tregtare, etj. Aksionar i vetëm i shoqërisë është shoqëria OTP Bank NYRT, e cila është shoqëria mëmë përfundimtare e Grupit.

5. **Shitësi: Business Lease Group B.V.** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Holandës.
6. **Shoqëria target: Business Lease Hungary Kereskedelmi és Szolgáltató Korlátolt Felelősségű Társaság (Business Lease Hungary Kft.)** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hungarisë, me objekt aktiviteti kryesor: dhënia me qira e automjeteve të pasagjerëve (veturave), agjenci sigurimi, aktivitete ndërmjetësimi (brokeri), aktivitete të tjera ndihmëse në fushën e sigurimeve dhe fondeve të pensionit, të paklasifikuara në kategori tjetër, etj.
7. Shoqëria target nuk ushtron veprimtari tregtare apo të ketë filiale në Shqipëri dhe nuk gjeneron të ardhura në tregun shqiptar.

II. Përqendrimi

8. Më datë [...] 2026, ndërmjet shoqërisë Business Lease Group B.V (shitësi) dhe Merkantil Bank Zrt. (blerësi) është nënshkruar "Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e të gjitha aksioneve të emetuara në shoqërinë Business Lease Hungary Kft.", për shitjen nga shitësi dhe blerjen nga blerësi të aksioneve, dhe për çdo çështje lidhur, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë marrëveshje.
9. Shitësi inicioi një proces ankandi të kontrolluar me disa palë interesi, duke përfshirë blerësin. Blerësi i paraqiti shitësit një ofertë jo-detyruese më datë [...] 2026 për Aksionet dhe një ofertë detyruese për të njëjtat më datë [...] 2026, kjo e fundit përfshinte një version të rishikuar të kësaj marrëveshje. Më pas blerësi u përzgjodh si blerës.
10. Pas finalizimit, me kërkesën e Grupit të Blerësit, për përdorimin e vazhdueshëm të disa njohurive, sistemeve dhe mekanizmave që përdoren aktualisht nga shoqëria target dhe operohen nga grupi i shitësit, Grupi i shitësit ka rënë dakord që të ofrojë shërbime të caktuara për shoqërinë dhe anëtarët e tjerë të grupit të blerësit, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje (shërbimet pas finalizimit dhe ndarja e sistemit të IT-së), për një periudhë të kufizuar pas finalizimit derisa Grupi i Blerësit të zëvendësojë Grupin e Shitësit në ofrimin e këtyre shërbimeve.
11. Në datën e finalizimit, shitësi do ti transferojë aksionet tek blerësi pa asnjë barrë dhe së bashku me të gjitha të drejtat që lidhen me to, dhe blerësi do të pranojë transferimin e këtyre aksioneve.
12. Para nënshkrimit të kësaj Marrëveshje, palët morën të gjitha miratimet e brendshme të nevojshme për të nënshkruar këtë marrëveshje dhe për të përmbushur detyrimet e tyre sipas saj.

13. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë Business Lease Hungary Kft. nga shoqëria Merkantil Bank Zrt., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

14. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i qirasë operative dhe administrimit të flotës, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
15. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë Business Lease Hungary Kft. nga shoqëria Merkantil Bank Zrt.
16. Merkantil Bank Zrt. është një shoqëri e specializuar në financimin e automjeteve dhe pajisjeve, duke përfshirë kredi dhe leasing për makina, automjete komerciale, makineri dhe asete të tjera prodhuese, pjesë e Grupit OTP.
17. Grupi OTP ofron një gamë të gjerë shërbimesh bankare dhe financiare në Shqipëri përmes Banka OTP Albania SHA, por nuk është aktive në tregun përkatës të shërbimeve të qirasë operative (leasing afatgjatë automjetesh) dhe administrimit të flotës.
18. Shoqëria target, Business Lease Hungary Kft., është aktive në dhënien me qira për një periudhë afatgjatë të makinave të pasagjerëve dhe automjeteve të lehta për përdorim komercial (qira operative) dhe në ofrimin e një sërë shërbimesh për administrimin e flotës, por. nuk është prezente dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri..
19. Sa më sipër, përqendrimi nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjellë ndryshim dhe nuk ka ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të shoqërisë Business Lease Hungary Kft. nga shoqëria Merkantil Bank Zrt.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1321, Datë 11.09.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË CELLCENTRIC GMBH & CO. KG NGA SHOQËRITË TOYOTA MOTOR CORPORATION, AKTIEBOLAGET VOLVO DHE DAIMLER TRUCK AG".

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë cellcentric GmbH & Co. KG nga shoqëritë Toyota Motor Corporation, Aktiebolaget Volvo dhe Daimler Truck AG.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë cellcentric GmbH & Co. KG nga shoqëritë Toyota Motor Corporation, Aktiebolaget Volvo dhe Daimler Truck AG",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e propozuar të përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë cellcentric GmbH & Co. KG nga shoqëritë Toyota Motor Corporation, Aktiebolaget Volvo dhe Daimler Truck AG.
2. Referuar dokumentit "Marrëveshje Investimi", palët në marrëveshje janë:
3. **Pala 1: Toyota Motor Corporation** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Japonisë, me objekt aktiviteti prodhimi, shitja, dhënia me qira dhe riparimi i automobilave, mjeteve industriale, anijeve, avionëve, pajisjeve të tjera të transportit dhe pajisjeve hapësinore, si dhe pjesëve të tyre; prodhimi, shitja, dhënia me qira dhe riparimi i makinerive dhe pajisjeve industriale dhe pjesëve të tyre, pajisjeve elektrike dhe pjesëve të tyre, riparimi i instrumenteve matëse, instrumenteve mjekësore dhe pjesëve të tyre;

transporti tokësor, detar, ajror, trajtimi i ngarkesave, magazinimi dhe shërbimet e agjencive të udhëtimit etj.

4. Toyota Motor Corporation është shoqëria mëmë përfundimtare e Grupit Toyota. Në Shqipëri, Toyota Motor Corporation realizon të ardhura nëpërmjet importuesve të pavarur vendas dhe rrjeteve të shitësve të autorizuar, përfshirë Toyota Auto Albania, e cila vepron si përfaqësuese e autorizuar e Toyota-s në Shqipëri.
5. **Pala 2: Aktiebolaget Volvo** është një shoqëri publike e kufizuar, e regjistruar sipas legjislacionit të Suedisë, aktive globalisht në prodhimin dhe shitjen e kamionëve, autobusëve, pajisjeve të ndërtimit, motorëve detarë, motorëve industrialë për aplikime jashtë rrugës dhe gjenerimit të energjisë, si dhe motorëve për automjete në autostradë.
6. Aktiebolaget Volvo është shoqëria mëmë e Grupit Volvo, të cilët realizojnë të ardhura në Shqipëri nëpërmjet shitësve të autorizuar, përfshirë Mektrin Motors SHPK, përfaqësuesin zyrtar të Volvo Trucks në Shqipëri.
7. Aktiebolaget Volvo është aksionari i vetëm i Volvo Fuel Cell Holding AB, shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Suedisë.
8. **Pala 3: Daimler Truck AG** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Gjermanisë, me objekt veprimtaria e drejtpërdrejtë ose e tërthortë në fushën e zhvillimit, prodhimit dhe shitjes së produkteve, si dhe ofrimi i shërbimeve, veçanërisht në këto sektorë: automjetet, veçanërisht automjete komerciale dhe autobusë, motorë dhe sisteme teknike shtytëse të çdo lloji, përfshirë pjesët, komponentët dhe aksesorët e tyre; produkte të tjera të teknologjisë së transportit; pajisjet, instalimet dhe sistemet elektronike; shërbimet dhe konceptet e lëvizshmërisë dhe transportit etj.
9. Daimler Truck AG zotërohet plotësisht nga Daimler Truck Holding AG. Daimler Truck AG është aksionari i vetëm i DTFC Holding GmbH, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë.
10. Në Shqipëri, Daimler Truck AG realizon të ardhura nëpërmjet importuesve dhe shpërndarësve të pavarur vendas, si Star Import d.o.o. Beograd, shpërndarësi i autorizuar i automjeteve Mercedes – Benz.
11. **Shoqëria target: cellcentric GmbH & Co. KG** është një sipërmarrje e përbashkët me funksione të plota, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë. cellcentric GmbH & Co. KG zhvillon, prodhon dhe tregton sisteme qelizash karburanti me hidrogjen (FCS) për përdorim në kamionë të rëndë dhe aplikime të tjera me kërkesa të krahasueshme në të gjithë botën, duke përfshirë autobusë dhe automjete të tjera të rënda.
12. Përpara mbylljes së transaksionit të propozuar, Aktiebolaget Volvo nëpërmjet degës së saj Volvo Fuel Cell Holding AB dhe Daimler Truck AG nëpërmjet degës së saj DTFC Holding GmbH, mbajnë aksione të barabarta dhe kontrollojnë bashkërisht shoqërinë target.
13. Partneri i vetëm i përgjithshëm i cellcentric GmbH & Co. KG është cellcentric Verwaltungsgesellschaft mbH, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë (Partneri i Përgjithshëm).

14. Shoqëria Target nuk ka prani dhe aktivitete në Shqipëri. Cellcentric nuk është aktiv dhe nuk pritet të bëhet aktiv në të ardhmen në Shqipëri.

II. Përqendrimi

15. Më datë [_____], shoqëritë Toyota Motor Corporation, Aktiebolaget Volvo, Volvo Fuel Cell Holding AB (Volvo HoldCo), Daimler Truck AG, DTFC Holding GmbH (Daimler HoldCo), cellcentric GmbH & Co. KG (Shoqëria) dhe cellcentric Verwaltungsgesellschaft mbH (Partneri i Përgjithshëm) kanë nënshkruar "Marrëveshje Investimi".
16. [_____]
17. [_____]
18. [_____]
19. [_____]
20. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë cellcentric GmbH & Co. KG nga shoqëritë Toyota Motor Corporation, Aktiebolaget Volvo dhe Daimler Truck AG, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenit 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

21. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i zhvillimit, prodhimit dhe tregtimit të sistemeve të qelizave të karburantit me hidrogjen, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
22. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë cellcentric GmbH & Co. KG nga shoqëritë Toyota Motor Corporation, Aktiebolaget Volvo dhe Daimler Truck AG..
23. Toyota Motor Corporation është një prodhues shumëkombësh automobilash, kryesisht aktiv në zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve duke filluar nga makinat kompakte deri te SUV-të dhe kamioncinat, si edhe autobusëve. Toyota nuk ka asnjë degë, filial apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri, por realizon shitje nëpërmjet importuesve të pavarur vendas dhe rrjeteve të shitësve të autorizuar.
24. cellcentric GmbH&Co. KG është një sipërmarrje e përbashkët me funksione të plota në pronësi dhe kontrollohet në pjesë të barabarta nga shoqëritë Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo. Cellcentric nuk ka prani dhe nuk ka aktivitete në Shqipëri.
25. Transaksioni i propozuar nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjell ndryshim dhe nuk ka ndikim në tregun shqiptar. Ky

përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë cellcentric GmbH & Co. KG nga shoqëritë Toyota Motor Corporation, Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1322, Datë 11.09.2026

"MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 1181, DATË 05.06.2025 "MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK NGA SHOQËRIA UNION BANK SHA"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi zbatimin e vendimit nr. 1181, datë 05.06.2025 "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK nga shoqëria UNION BANK SHA".

Baza Ligjore: Nenet 2, neni 8 dhe 9, neni 24, germa d), dhe neni 28, germa d) të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Udhëzimi "Mbi zbatueshmërinë e nenit 8 dhe 9 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1181, datë 05.06.2025 "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK nga shoqëria UNION BANK SHA",

VËREN SE :

I Procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës u njoftua se UNION BANK SHA synonte përftimin e kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK. UNION BANK SHA ishte e licencuar nga Banka e Shqipërisë si një bankë e nivelit të dytë, e cila përmes shoqërisë që zotëron, LANDESLEASE SHA, ofronte produkte të qirasë financiare.
2. ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK ishte e licencuar nga Banka e Shqipërisë si Institucion Financiar JoBankë për të ofruar veprimtari të qirasë financiare.
3. Gjatë procedurave të kontrollit të përqendrimeve, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se, transaksioni i njoftuar përbënte një përqendrim horizontal. Referuar të dhënave të administruara, u konstatua se tregu i qirasë financiare kishte karakteristikat e një tregu të përqendruar ku indeksi HHI (indeksi i përqendrimit te tregut) ishte mbi 2000, si para dhe

pas transaksionit dhe delta HHI ishte 292. Numri i subjekteve që operonin në këtë treg ishte 9 subjekte, por asnjëra prej tyre nuk kishte pozitë dominuese.

4. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 1181, datë 05.06.2025, "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK nga shoqëria UNION BANK SHA" vendosi:
   1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK nga shoqëria UNION BANK SHA.
   2. Mbajtjen në monitorim të tregut të qirasë financiare nga IFJB për një periudhë 1 vjeçare nga dhënia e autorizimit.
5. Për realizmin e procedurës së monitorimit, Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 28, germa d), nenit 33 dhe 34 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës (ligji), kërkoi informacion nga shoqëritë Landeslease SHA dhe ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK, në lidhje me Normën Nominale mesatare vjetore të interesit dhe Normën Efektive të Interesit (NEI) mesatare vjetore për kontratat e qirasë financiare gjatë viteve 2024, 2025 dhe 2026; gjithashtu kërkoi informacion nga Banka e Shqipërisë mbi volumin e portofolit të produktit qira financiare për vitin 2025, sipas IFJB-ve të licencuara për këtë produkt.
6. Në përgjigje të kërkesave, Autoriteti i Konkurrencës administroi informacion e kërkuar, mbi bazën e të cilit realizoi procedurën e monitorimit të tregut të qirasë financiare për periudhën qershor 2025-qershor 2026.

II Analiza e Konkurrencës

Analiza e konkurrencës u mbështet në metodologjinë Strukturë-Sjellje-Performancë.

7. Për vlerësimin e efekteve që transaksioni i njoftuar do të sillte në treg, analiza e konkurrencës u krye mbi tregun e prekur nga transaksioni. Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës i produktit u konsiderua tregu i qirasë financiare. "Qira financiare" është marrëdhënia juridike, sipas së cilës qiradhënësi i blen furnizuesit një send të përzgjedhur nga qiramarrësi pranë furnizuesit dhe ia jep atë qiramarrësit për ta përdorur për një afat të caktuar, kundrejt një çmimi të caktuar në kontratë dhe, me mbarimin e afatit të kontratës, qiramarrësi mund ta blejë sendin, të vazhdojë ta mbajë me qira për një afat tjetër ose t'ia kthejë atë qiradhënësit.
8. *Vlerësimi i strukturës së tregut përkatës* u mbështet në të dhënat e administruar nga Banka e Shqipërisë, mbi volumin e portofolit të produktit qira financiare për vitin 2025, sipas IFJB-ve. Nga analiza, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se gjatë periudhës së monitorimit vihet re se nuk ka ndryshime thelbësorë lidhur me pjesën e tregut që zë secila shoqëri për produktin "Qira financiare". Indeksi i përqendrimin HHI, paraqitët në vlerën 2416 dhe delta HHI 200, me një përmirësim të lehtë krahasuar me vlerësimin e vitit 2023.
9. *Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve* objekt monitorimi, është mbështetur në politikat e ndërmarrjeve në lidhje me përcaktimin e normave të interesit të aplikuar, për të parë nëse

ka patur ndryshime mbi normat e aplikuara të interesit për produktin "Qira financiare" si rezultat i përqendrimit. Për këtë arsye, palëve pjesëmarrëse në këtë transaksion iu është kërkuar informacion lidhur me aplikimin e normës nominale të interesit dhe normës efektive të interesit, mesatare vjetore për periudhën para dhe pas transaksionit për të gjitha financimet e reja të disbursuara.

10. Nga analiza, Komisioni i Konkurrencës konstatoi se ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK ka raportuar një rënie të lehtë të normave të aplikuara për kontratat e lidhura për vitin 2025, ndërkohë që Landeslease SHA nuk ka ndryshim të normave të interesit. ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK ka informuar se shoqëria nuk ka lidhur kontrata të reja të qirasë financiare për vitin 2026, pasi i gjithë portofoli i qirasë financiare është çeduar tek Landeslease SHA. Si rrjedhojë qiraja financiare nuk do të jetë më pjesë e veprimtarisë së ardhshme të shoqërisë.
11. Sipas të dhënave të disponueshme, Komisioni i Konkurrencës nuk evidentoi ndryshime të interesave të aplikuara gjatë periudhës së monitorimit për produktin "Qira financiare", si pasojë e përqendrimit.
12. *Analiza e performancës* është një tregues i rëndësishëm për të vlerësuar potencialin ekonomik të ndërmarrjes për të konkurruar dhe performuar pozitivisht në treg. Kjo përcakton aftësinë konkurruese të një ndërmarrje në raport me konkurrentet e saj.
13. Nga vlerësimi i pasqyrave financiare të shoqërive Landeslease SHA dhe ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK u konstatua se, Landeslease paraqet një pozicion shumë më të fortë financiar, ndërkohë që ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION operon në përmasa më të vogla, me të ardhura dhe aktive dukshëm më të ulëta se Landeslease. Treguesit e vitit 2025 reflektojnë sistemimet në treguesit financiar, të cilët kanë reflektuar ndryshimin e kontrollit të shoqërisë dhe përcaktimin e politikave te reja të Drejtimit.
14. Nga sa është deklaruar, Union Bank SHA do të orientojë aktivitetin e ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK në shërbimin e mikrokredisë.
15. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës nuk konstatoi elemente të një shkelje të mundshëm të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" në tregun e qirasë financiare nga IFJB për shoqëritë Landeslease SHA dhe ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, germa d të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të mbyllë procedurën e monitorimit mbi zbatimin e vendimit nr. 1181, datë 05.06.2025, "Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION SHPK nga shoqëria UNION BANK SHA".

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1323, Datë 11.09.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË EVERLLENCE SE NGA SHOQËRITË VOLKSWAGEN AKTIENGESELLSCHAFT DHE NIKOLAUS (BC) BIDCO GMBH".

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Everllence SE nga shoqëritë Volkswagen Aktiengesellschaft dhe Nikolaus (BC) Bidco GmbH.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Everllence SE nga shoqëritë Volkswagen Aktiengesellschaft dhe Nikolaus (BC) Bidco GmbH",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Everllence SE nga shoqëritë Volkswagen Aktiengesellschaft dhe Nikolaus (BC) Bidco GmbH.
2. Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: Nikolaus (BC) Bidco GmbH** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar për qëllime të transaksionit të propozuar, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti themelimi, blerja, mbajtja, administrimi dhe shitja e ndërmarrjeve, e pjesëmarrjeve në ndërmarrje dhe aktivitete të tjera, marrja përsipër e menaxhimit dhe

përfaqësimit të shoqërive, si dhe ofrimi i funksioneve holding dhe menaxhimit etj. Blerësi kontrollohet, në mënyrë të tërthortë, nga [_____].

4. [_____]
5. Shoqëritë e portofolit të kontrolluara nga Bain Capital nuk kanë asnjë filial në Shqipëri, por kanë realizuar xhiro nëpërmjet aktiviteteve të një numri të kufizuar të shoqërive të portofolit që ajo kontrollon.
6. **Shitësi: Volkwagen Vermögensverwaltungs - GmbH** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, shoqëri e grupit Volkwagen AG.
7. **Shoqëria target: Everllence SE** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Gjermanisë, me objekt aktiviteti: zhvillimi, projektimi, prodhimi, shitja dhe shërbimi i makinerive dhe pajisjeve të të gjitha llojeve, në veçanti motorëve me naftë të të gjitha llojeve dhe për të gjitha aplikimet, duke përfshirë motorët detarë dhe motorët për instalime stacionare, dhe turbomakineritë dhe kompresorët, si dhe ofrimi i të gjitha shërbimeve të lidhura, duke përfshirë licencimin.
8. Everllence SE zotërohet plotësisht [_____].
9. Volkswagen Aktiengesellschaft është shoqëria mëmë e Grupit Volkswagen, i cili është aktiv në tregun ndërkombëtar kryesisht në zhvillimin, prodhimin, tregtimin dhe shitjen e makinave të pasagjerëve, automjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, shasive për autobusë dhe motorët me naftë, biçikleta motorike, duke përfshirë edhe prodhimin e pjesëve rezervë dhe pajisjeve shtesë. Grupi Volkswagen gjithashtu angazhohet dhe në shpërndarjen e automjeteve.
10. Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

- Porsche Leasing SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: veprimtari e qirasë financiare, agjent në sigurime.
- Porsche Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti; shitje me shumicë dhe pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, kryerje e riparimeve të të gjitha llojeve të automjeteve, përfshirë montimin e automjeteve të përfunduara, modifikim i automjeteve dhe prodhim i pjesëve dhe aksesorëve, etj.

II. Përqendrimi

11. Më datë [_____], ndërmjet Nikolaus (BC) Bidco GmbH (blerësi), Volkwagen Vermögensverwaltungs – GmbH (shitësi), Volkwagen Finance Luxemburg S.A. (Bashkë-Investitori) dhe Nikolaus Lux Finco S.à.r.l. (Investitori), është nënshkruar "Marrëveshja e Opsionit", lidhur me shitjen dhe blerjen e të gjitha aksioneve në Blitz F26- 341 GmbH, shoqëria e ardhshme zotëruese holding e Everllence SE.
12. Referuar kësaj Marrëveshje, [_____].
13. [_____]

14. [_____]

15. [_____]

16. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Everllence SE nga shoqëritë Volkswagen Aktiengesellschaft dhe Nikolaus (BC) Bidco GmbH, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

17. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës i produktit do të konsiderohet: (i) tregu për prodhimin dhe furnizimin me motorë; (ii) tregu për prodhimin dhe furnizimin me gjeneratorë; (iii) tregu për prodhimin dhe furnizimin me turbongarkues; (iv) tregu për prodhimin dhe furnizimin me turbomakineri; dhe (v) tregu pas shitjes dhe shërbimet teknike përkatëse për pajisjet industriale dhe detare, përfshirë turbomakineritë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

18. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Everllence SE nga shoqëritë Volkswagen Aktiengesellschaft dhe Nikolaus (BC) Bidco GmbH.

19. Nikolaus (BC) Bidco GmbH është një shoqëri e themeluar për realizimin e Transaksionit, e cila kontrollohet nga fondet e administruara dhe/ose nën konsulencën e Bain Capital, një shoqëri investimesh private, e cila investon në shoqëri që ushtrojnë aktivitetin në një sërë sektorësh, përfshirë teknologjinë e informacionit, kujdesin shëndetësor, tregtinë me pakicë dhe produktet e konsumit, komunikimet, shërbimet financiare dhe industrinë/prodhimin.

20. Shoqëritë e portofolit të kontrolluara nga Bain Capital nuk kanë asnjë filial në Shqipëri, por kanë realizuar xhiro nëpërmjet aktiviteteve të një numri të kufizuar të shoqërive të portofolit që ajo kontrollon.

21. Everllence SE është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti në fushën e inxhinierisë së specializuar në zgjidhje për shtytjen, dekarbonizimin dhe efikasitetin për industrinë detare, sektorin e energjisë dhe aplikimet industriale.

22. Everllence SE është pjesë e Grupi Volkswagen, i cili operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij: Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të automjeteve të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, dhe në tregun e dhënies së qerasë financiare dhe shërbimin e sigurimeve të lidhura me shitjet e automjeteve.

23. Nga sa më sipër, transaksioni i propozuar nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve, në tregun përkatës të produktit, në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjell ndryshim

dhe nuk ka ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë Everllence SE nga shoqëritë Volkswagen Aktiengesellschaft dhe Nikolaus (BC) Bidco GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1324, Datë 11.09.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË LUMINOR HOLDING AS NGA SHOQËRIA OTP BANK NYRT."

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të shoqërisë Luminor Holding AS nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit të shoqërisë Luminor Holding AS nga shoqëria OTP Bank Nyrt.",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit të shoqërisë Luminor Holding AS nga shoqëria OTP Bank Nyrt.
2. Referuar dokumentit "Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e kapitalit aksionar të emetuar në Luminor Holding AS.", nënshkruar më datë [_____], palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: OTP Bank Nyrt./ OTP Bank Plc**, është një shoqëri aksionare, e listuar publikisht me një strukturë pronësie ndërkombëtare, kryesisht e përbërë nga investitorë privatë dhe institucional, i themeluar sipas legjislacionit Hungarez me emrin Országos Takarék Pénztár (Bankës Kombëtare të Kursimeve), me qëllim ofrimin e shërbimeve të depozitave dhe huadhënies për klientët me pakicë, e cila aktualisht ka si veprimtari kryesore: Ndërmjetësime monetare të tjera.
4. Grupi OTP është aktiv në Shqipëri, nëpërmjet shoqërisë Banka OTP Albania SHA, një shoqëri aksionare, themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: a) Pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre

për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet, b) dhënie huash të të gjitha llojeve duke përfshirë kredi konsumatorësh dhe kredi hipotekore, c) faktoring dhe financim të transaksioneve tregtare, etj. Aksionar i vetëm i shoqërisë është shoqëria OTP Bank NYRT, e cila është shoqëria mëmë përfundimtare e Grupit.

5. **Shitësit:**
   - **DNB Baltic Invest AB** është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Suedisë, zotëruese e X% të aksioneve në shoqërinë target.
   - **Entiteti Shitës: Braavos Bidco Limited** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Jersey, zotëruese e X% të aksioneve në shoqërinë target.

6. Shoqëria target: **Luminor Holding AS** është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Estonisë, dhe me objekt aktiviteti: Aktivitetet e shoqërisë mbajtëse (holding). [_____].
7. [_____]:
   - [_____];
   - [_____];
   - [_____].
8. Grupi Target ofron një gamë të gjerë shërbimesh bankare për individë dhe biznese, si dhe shërbime leasingu, menaxhim të fondeve të pensionit dhe shërbime pagesash elektronike në Estoni, Letoni dhe Lituani.
9. Shoqëria target nuk ushtron veprimtari tregtare apo të ketë filiale në Shqipëri dhe nuk gjeneron të ardhura në tregun shqiptar.

II. Përqendrimi

10. Më datë [_____], ndërmjet shoqërisë DNB Baltic Invest AB (shitësi), Braavos Bidco Limited (Entiteti shitës) dhe OTP Bank Nyrt. (blerësi) është nënshkruar "Marrëveshje për shitjen dhe blerjen e kapitalit aksionar të emetuar në Luminor Holding AS.
11. [_____].
12. [_____].
13. [_____].
14. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të shoqërisë Luminor Holding AS nga shoqëria OTP Bank Nyrt., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

15. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të

ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

16. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të plotë të shoqërisë Luminor Holding AS nga shoqëria OTP Bank Nyrt.
17. OTP Bank Nyrt. është një shoqëri aksionare, shoqëria mëmë e Grupit OTP, aktiv në ofrimin e shërbimeve bankare. Grupi OTP është aktiv në tregun shqiptar nëpërmjet filialit të tij Banka OTP Albania SHA, një shoqëri aksionare, themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: a) Pranimi i depozitave monetare ose i fondeve të tjera të ripagueshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari te vet, b) dhënie huash të të gjitha llojeve duke përfshirë kredi konsumatorësh dhe kredi hipotekore, c) faktoring dhe financim të transaksioneve tregtare, etj.
18. Sipas treguesve kryesor të sistemit bankar, bankat me pjesën më të madhe në tregun shqiptar janë: BKT, Banka Credins dhe Banka Raiffeisen. Referuar treguesve kryesor të sistemit, OTP Bank Albania SHA zë rreth X% të tregut të aseteve, X% të tregut të kredive dhe X% të tregut të depozitave.
19. Luminor Holding AS është një shoqëri holding e cila përmes filialeve / degëve të saj ofron një gamë të gjerë shërbimesh bankare, si dhe qira, menaxhim fondesh pensioni dhe ofron pagesa e-commerce për vendet baltike. Luminor Holding, së bashku me degët dhe filialet e saj, nuk është prezent dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.
20. Sa më sipër, përqendrimi nuk krijon mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk sjell ndryshim dhe nuk ka ndikim në tregun shqiptar. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të shoqërisë Luminor Holding AS nga shoqëria OTP Bank Nyrt.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1325, Datë 11.09.2026

"PËR VAZHDIMIN E PËRJASHTIMIT NGA NDALIMI TË MARRËVESHJES SË LIDHUR MIDIS SHOQËRIVE TË SIGURIMIT PËR KARTONIN JESHIL"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2026,shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil.

Baza Ligjore: Neni 4, neni 5, neni 24, shkronja (d), neni 26, nenet 48-52 dhe neni 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", (ligji nr. 9121/2003), ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm "Mbi kërkesën e BSHS për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil",

VËREN SE :

I. Procedura e ndjekur:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 1101, datë 29.08.2024 "Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil", ka vendosur:

   a. Të vazhdojë përjashtimin nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.
   b. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:
      i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, dhe hyn në fuqi që nga momenti i depozitimit të kërkesës së BSHS për zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.

ii. Secila prej ndërmarrjeve të sigurimit, pjesë e marrëveshjes, duhet të tregtojë produktin e kartonit jeshil nëpërmjet agjentëve të saj në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" dhe polica e sigurimit duhet të përmbajë logon e ndërmarrjes që e tregton dhe barkodin përkatës, duke shmangur koordinimin e sjelljes lidhur me ndarjen e pjesëve të tregut dhe caktimit të çmimeve mes palëve njoftuese të marrëveshjes.

c. T'i rekomandojë Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe ndërmarrjeve të sigurimit që të marrin masat për përgatitjen e kartonit jeshil në formatit elektronik PDF, sipas rekomandimeve nga Këshilli i Byrove.
d. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.
e. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.

2. Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar me Byronë Shqiptare të Sigurimit (BSHS) dhe shoqëritë e sigurimit, duke kërkuar informacion lidhur me zbatimin e Vendimit nr. 1101, datë 29.08.2024, për të gjithë periudhën e përjashtimit nga ndalimi të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

3. Nga monitorimi i zbatimit të Vendimit nr. 1101, datë 29.08.2024, si dhe nga informacioni i administruar nga BSHS dhe shoqëritë e sigurimit, ka rezultuar se palët pjesëmarrëse në Marrëveshjen e Bashkëpunimit kanë respektuar kushtet dhe detyrimet e përcaktuara nga Komisioni i Konkurrencës. Marrëveshja është zbatuar pa ndryshime apo amendime dhe nuk janë konstatuar raste të mosrespektimit të kushteve për të cilat është dhënë përjashtimi nga ndalimi, si dhe sjellje të koordinuara ndërmjet palëve lidhur me ndarjen e tregut ose caktimin e çmimeve.

4. Gjatë periudhës së monitorimit, produkti "Karton Jeshil" ka vijuar të tregtohet nga secila shoqëri sigurimi nëpërmjet rrjetit të saj të agjentëve të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me ligjin nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", aktet nënligjore në fuqi dhe Rregulloren e Këshillit të Byrove. Çdo policë sigurimi përmban elementet identifikuese dhe të sigurisë të operatorit emetues, përfshirë logon e shoqërisë së sigurimit dhe barkodin përkatës, elemente të cilat evidentohen edhe në specimenët e Kartonit Jeshil të përcjellë nga BSHS për secilën shoqëri sigurimi.

5. Lidhur me zbatimin e rekomandimit të përcaktuar në pikën 3 të Vendimit nr. 1101, datë 29.08.2024, BSHS ka bërë me dije se, në bashkëpunim me shoqëritë e sigurimit, janë ndërmarrë dhe vijon të ndërmarrë masat teknike dhe organizative për implementimin e Kartonit Jeshil në format elektronik (PDF) dhe me kod QR, në përputhje me standardet e Këshillit të Byrove dhe lehtësimin e lëvizjes ndërkufitare të mjeteve motorike.

6. Shoqëritë e sigurimit kanë konfirmuar ndërmarrjen e masave për implementimin e Kartonit Jeshil në format elektronik (PDF) dhe integrimin e kodit QR, në koordinim me BSHS-në dhe AMF-në, duke parashikuar përfundimin e procesit deri në fund të vitit 2026 dhe fillimin e vitit 2027.

7. Nga shqyrtimi i kopjeve të policave "Karton Jeshil" të përcjella nga shoqëritë e sigurimit rezulton se ato përmbajnë kodin QR dhe elementet përkatëse identifikuese dhe të sigurisë. Për rrjedhojë, rezulton se janë ndërmarrë hapa konkretë për zbatimin e rekomandimit të Komisionit të Konkurrencës, ndërsa procesi për lëshimin dhe tregtimin e plotë të Kartonit Jeshil në format elektronik vijon të jetë në fazën e implementimit.

8. BSHS, me shkresën nr. 622/3 prot., datë 22.07.2026, "Kërkesë për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mbi shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil", ka konfirmuar se gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Vendimit nr. 1101, datë 29.08.2024, shoqëritë e sigurimit pjesëmarrëse në marrëveshje kanë respektuar kushtet dhe detyrimet e vendosura nga Komisioni i Konkurrencës, duke kërkuar, në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të Marrëveshjes së Bashkëpunimit deri në vitin 2029.

9. Kërkesa për vazhdimin e përjashtimit është paraqitur pas përfundimit të afatit të përjashtimit të përcaktuar në Vendimin nr. 1101, datë 29.08.2024, dhe synon vijimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për shitjen dhe administrimin e produktit "Karton Jeshil".

II. Palët në marrëveshje

10. Palët në marrëveshje janë të gjitha shoqëritë e sigurimit të cilat e ofrojnë produktin e kartonit jeshil të sigurimit të mjeteve motorike.

III. Përshkrimi i marrëveshjes

11. Objekt i kësaj marrëveshje është vendosja e një marrëdhënie bashkëpunimi mes shoqërive të sigurimit në tregun e sigurimeve të detyrueshme të mjeteve motorike të kartonit jeshil, lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil me qëllim kryesor përmirësimin dhe rritjen e garancisë.

12. Sipas BSHS, marrëveshja lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil parashikon përjashtimin nga ndalimi të disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve, të cilat kanë për objekt bashkëpunimin në lidhje me:
    i. Vendosjen e tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve;
    ii. Vendosjen e kushteve të policave standarde të përbashkëta për eliminimin e policave false dhe vendosjen e sistemit të kodit unikal-bar kod dhe njoftimin në kohë reale në sistemin e informacionit të AMF-së të çdo police të kartonit jeshil;

iii. Shlyerja e dëmeve (parashikohet rritja e pagesës së dëmeve dhe marrja përsipër nga shoqëritë e sigurimit të pagesës së dëmeve duke shmangur policat false, të cilat ekspozonin qytetarët që kanë marrë këtë produkt para përgjegjësive penale dhe financiare për dëmet e shkaktuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me mjetet e tyre motorike);

iv. Testimi dhe pranimi i pajisjeve të sigurisë (sistemi i kodit unikal dhe verifikimi nëpërmjet pajisjeve të sigurisë në pikat e kalimit kufitar për verifikimin e bar-kodit unikal që vlerëson nëse polica e sigurimit të kartonit jeshil është e vlefshme dhe është sipas klasës së mjetit motorik).

13. Qëllimi i marrëveshjes është:

i. Shitja e policave të kartonit jeshil nëpërmjet një numri të autorizuar operatorësh në pikat e kalimit kufitar dhe degët qendrore të shoqërive të sigurimit;

ii. Procesi i shitjes të realizohet me anë të shoqërisë së brokerimit të autorizuar nga Byroja, e cila ka stafin teknik, sistemin e shitjes online në kohë reale që mundëson gjenerimin e Kodit Unikal (Nr. serial – bar kod) dhe broker fizik të licencuar.

iii. Të rrisë garancinë dhe sigurinë e këtij shërbimi në përputhje me standardet COB (Këshillit të Byrove), shmangien e kolapsit për përjashtimin e BSHS nga Sistemi Ndërkombëtar i Kartonit Jeshil;

iv. Rritjen e garancisë së drejtuesve të mjeteve, të cilët përdorin automjete përtej kufirit të RSH, të cilët duhet të jenë të siguruar kur hyjnë në vende ku një sigurim i tillë është i detyrueshëm;

v. Forcimin e sigurisë financiare të ofertuesve të këtij sigurimi.

14. Sipas BSHS kjo marrëveshje ka efekte vetëm për produktin karton jeshil, i cili zë një pjesë të vogël të totalit të tregut të sigurimeve dhe i shtrin efektet në zonën gjeografike të territorit të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja nuk kufizon lirinë tregtare dhe lirinë konsumatore për të përzgjedhur produktin dhe shoqërinë sipas kërkesës së tij.

IV. Tregu Përkatës

a. Tregu përkatës i produktit

15. Kartoni Jeshil mbulon përgjegjësinë civile të mbajtësit të mjetit motorik, ndaj dëmeve që u shkakton palëve të treta, në përputhje me parashikimin e Ligjit të një prej shteteve anëtare të Këshillit të Byrove, ku ka ndodhur rasti në sigurim. "Kartoni jeshil" është certifikata ndërkombëtare e sigurimit, e cila rregullon marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet zyrave kombëtare të vendeve anëtare të sistemit të kartonit jeshil. Drejtuesi i mjetit motorik, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me një mjet, me regjistrim të huaj, duhet të jetë i pajisur me: a) karton jeshil, të vlefshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë; b) dokument tjetër të vlefshëm, që vërteton ekzistencën e sigurimit të përgjegjësisë ndaj palëve të treta, në ato raste kur ka një marrëveshje të veçantë dypalëshe, për mjetet me targë regjistrimi të shtetit tjetër, nënshkrues të kësaj marrëveshjeje.

16. Kjo policë lëshohet në territorin e Shqipërisë vetëm për automjetet me targa shqiptare dhe vepron jashtë territorit të Shqipërisë. Për njohjen e vlefshmërisë së dokumenteve ndërkombëtare të sigurimit, byroja njofton paraprakisht, autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar. Autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar janë të detyruara të kontrollojnë përmbushjen e kërkesave, të parashikuara në ligj.

b. Tregu përkatës gjeografik

17. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene. Meqenëse produkti (shërbimi) ofrohet në të gjitha pikat e licencuara për tregtimin e kartonit jeshil atëherë si treg gjeografik do të jetë territori i Republikës së Shqipërisë.

V. Analiza e konkurrencës

18. Tregjet e sigurimeve në përgjithësi dhe kartonit jeshil në veçanti janë të rregulluar dhe të mbikëqyrur nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bazë të ligjit nr. 32/2021 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit.

19. Ndër 3 konkurrentët kryesorë në treg janë: Për vitin 2024 ndërmarrjet: XX me XX%, XX me XX% dhe XX me XX%; Për vitin 2025 ndërmarrjet: XX me XX%, XX me XX% dhe XX me XX%; Për periudhën janar – qershor 2026 ndërmarrjet: XX me XX%, XX me XX% dhe XX me XX%.

20. Sipas renditjes në vite ndërmarrja XX radhitet e para (2024 – 2025 dhe janar – qershor 2026) me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut gjatë gjithë periudhës, ndërmarrja XX renditet e dyta (2024 – 2025 dhe janar – qershor 2026) me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut, ndërmarrja XX gjithashtu me qëndrueshmëri të pjesëve të tregut.

21. Nga vlerësimi i indeksit HHI për periudhën 2024 – 2025 dhe janar – qershor 2026, ndërmarrjet kanë ruajtur pothuajse të njëjtën shkallë përqendrimi duke variuar nga 1,762.86 në vitin 2024, në 1,765.55 në vitin 2025 dhe 1,761.27 në janar – qershor 2026, duke qenë një treg me përqendrim të moderuar, por në nivelin e poshtëm të këtij të fundit. Kartoni jeshil për vitin 2025 zë një peshë specifike 11% në totalin e tregut të sigurimeve të mjeteve motorike.

VI. Arsyet e përjashtimit nga ndalimi

22. Sektori i sigurimeve është një nga sektorët e tregut financiar ku marrëveshjet mes operatorëve për qëllime të mbulimit të riskut të përbashkët dhe standardizimit të produkteve mund të përfitojnë nga përjashtimi nga ndalimi sipas parashikimeve të nenit 5 dhe neneve 48-52 të ligjit nr. 9121/2003 dhe akteve nënligjore që përfshijnë udhëzimin "Për formën e njoftimit të marrëveshjeve" dhe "Formularin për njoftimin e marrëveshjeve".

23. Duke qenë se afati i parashikuar në VKK nr. 1101, datë 29.08.2024, ka përfunduar, BSHS ka kërkuar në mbështetje të nenit 5 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e

konkurrencës", zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil, deri në vitin 2029.

24. Sipas BSHS, gjatë kësaj periudhe shoqëritë e sigurimit, anëtare të BSHS, kanë zbatuar kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në pikën 2 të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 1101, datë 29.08.2024.

25. BSHS ka theksuar se nga zbatimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka evidentuar rezultate pozitive për tregun dhe konsumatorët, ndër të cilat:
    a) Primi i sigurimit për Kartonin Jeshil me afat 1-vjeçar për mbulimin e territorit të Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut, është ulur, duke sjellë një përfitim të drejtpërdrejtë ekonomik për konsumatorët dhe duke konfirmuar se zbatimi i marrëveshjes nuk ka sjellë rritje artificiale të çmimeve të këtij produkti.
    b) është garantuar identifikimi i qartë i çdo operatori emetues nëpërmjet elementëve të sigurisë të policës së sigurimit;
    c) Në zbatim të Rekomandimit të Këshillit të Byrove, Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe shoqëritë anëtare kanë ndërmarrë dhe vijojnë të ndërmarrin të gjitha masat teknike dhe organizative për zbatimin e standardeve të reja të sistemit të Kartonit Jeshil, duke mundësuar lëshimin dhe pranimin e Kartonit Jeshil në format elektronik (PDF), si dhe implementimin gradual të Kartonit Jeshil me QR Code, në përputhje me kërkesat e Këshillit të Byrove. Këto masa synojnë përafrimin e sistemit shqiptar të Kartonit Jeshil me standardet e reja të Këshillit të Byrove dhe lehtësimin e lëvizjes ndërkufitare të mjeteve motorike.
    d) Kartoni Jeshil vijon të jetë i risiguruar pranë risiguruesve ndërkombëtarë me vlerësim të lartë financiar, duke garantuar stabilitetin e sistemit dhe mbrojtjen e të siguruarve;
    e) janë përmirësuar më tej procedurat e administrimit dhe likuidimit të dëmeve ndërkufitare.

26. BSHS me shkresën nr. 622/10 prot., datë 31.07.2026, ka bërë me dije se, gjatë periudhës objekt monitorimi, Marrëveshja e Bashkëpunimit ka vijuar të zbatohet në të njëjtat kushte për të cilat është dhënë përjashtimi nga ndalimi, pa ndryshime apo amendime dhe pa raste të konstatuara të mosrespektimit të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në Vendimin nr. 1101, datë 29.08.2024.

27. Sipas BSHS-së, Sistemi i Kartonit Jeshil ka funksionuar normalisht dhe në mënyrë të qëndrueshme, pa thirrje garancie me ndikim për BSHS-në, pa mosmarrëveshje me Byrotë homologe lidhur me administrimin e dëmeve ndërkufitare dhe pa raste të evidentuara të përdorimit të policave të falsifikuara ose të paautorizuara.

28. Në vijim, me shkresën nr. 622/24 prot., datë 25.08.2026, BSHS ka informuar se, për periudhën 2024–2026, Këshilli i Byrove nuk ka shprehur vlerësime apo raporte negative lidhur me veprimtarinë dhe performancën e saj.

29. BSHS ka sqaruar se modeli i mëparshëm kolektiv i risigurimit është zëvendësuar me modelin individual, sipas të cilit secila shoqëri anëtare siguron mbulimin me risigurim të detyrimeve që rrjedhin nga veprimtaria e Kartonit Jeshil. Përputhshmëria e marrëveshjeve individuale të risigurimit për vitin 2026 me ligjin nr. 52/2014 dhe aktet nënligjore në fuqi është konfirmuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Gjithashtu, çdo shoqëri anëtare duhet të depozitojë pranë BSHS-së, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, marrëveshjen e saj të risigurimit për vitin pasardhës.

30. Sipas informacionit të paraqitur nga BSHS, për mbështetjen e detyrimeve të sistemit janë në fuqi garanci bankare në vlerën totale prej XX euro në cilësinë e Byrosë Garantuese dhe XX euro në cilësinë e Byrosë Trajtuese. BSHS ka deklaruar gjithashtu se nuk ka detyrime financiare të papaguara ose të mbetura nga skemat e mëparshme kolektive të risigurimit dhe se shoqëritë e sigurimit kanë vijuar të përmbushin detyrimet ndaj palëve të dëmtuara.

31. BSHS ka vlerësuar se Marrëveshja e Bashkëpunimit vijon të përmbushë kushtet e përcaktuara në nenin 5 të ligjit nr. 9121/2003, pasi ka kontribuar në funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të Sistemit të Kartonit Jeshil, në mbrojtjen e konsumatorëve dhe në administrimin e dëmeve ndërkufitare, pa eliminuar ose kufizuar konkurrencën ndërmjet shoqërive pjesëmarrëse.

32. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të administruar, vlerësohet se Marrëveshja e Bashkëpunimit mbi shitjen dhe administrimin e Kartonit Jeshil:
    i. kontribuon në përmirësimin e shpërndarjes dhe administrimit të produktit "Karton Jeshil", nëpërmjet standardizimit të policës, identifikimit të operatorit emetues, përdorimit të barkodit dhe kodit QR, përmirësimit të administrimit të dëmeve ndërkufitare dhe garantimit të mbulimit me risigurim;
    ii. sjell përfitime për konsumatorët, të lidhura me uljen e primit për Kartonin Jeshil me afat njëvjeçar për mbulimin e territorit të Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut, rritjen e sigurisë së policës, reduktimin e mundësisë së falsifikimit dhe garantimin e kompensimit të palëve të dëmtuara;
    iii. kufizohet në elementet teknike dhe administrative të nevojshme për funksionimin e Sistemit të Kartonit Jeshil dhe nuk duhet të shtrihet në përcaktimin e çmimeve ose të primeve individuale, ndarjen e tregut apo të klientëve, kufizimin e shitjeve ose shkëmbimin e informacionit tregtar të ndjeshëm që nuk është i domosdoshëm për zbatimin e marrëveshjes; dhe
    iv. nuk eliminon konkurrencën ndërmjet shoqërive pjesëmarrëse, pasi secila shoqëri vijon ta tregtojë produktin në mënyrë të pavarur, nëpërmjet rrjetit të saj të agjentëve të licencuar. Megjithatë, duke qenë se palët në marrëveshje përfaqësojnë të gjithë operatorët që ofrojnë produktin "Karton Jeshil", ruajtja e pavarësisë së politikave tregtare dhe kufizimi i shkëmbimit të informacionit vetëm në të dhënat e domosdoshme duhet të garantohen nëpërmjet kushteve dhe detyrimeve të vendosura në vendimin e përjashtimit.

33. AMF, me shkresën nr. 622/25 prot., datë 27.08.2026, "Përgjigje tuajës nr. 622/1 prot., datë 10.08.2026", lidhur me kërkesën e BSHS-së për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit nr. 1101, datë 29.08.2024, ka bërë me dije se vlerësimi dhe miratimi i kërkesës për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për Kartonin Jeshil është në kompetencë të Autoritetit të Konkurrencës, në mbështetje të ligjit nr. 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu, AMF ka informuar se monitoron në mënyrë të vazhdueshme tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik, përfshirë produktin "Karton Jeshil", duke theksuar rëndësinë e respektimit të standardeve dhe kërkesave të Këshillit të Byrove për funksionimin e rregullt të këtij sistemi.

34. Lidhur me Kartonin Jeshil në format elektronik (PDF), AMF ka sqaruar se, referuar Vendimit nr. 9-1/2023 të Asamblesë së Përgjithshme të Këshillit të Byrove, nga data 1 janar 2025 mundësohet pranimi i policës në format elektronik në pikat e kalimit kufitar, për të cilën BSHS ka njoftuar strukturat përgjegjëse. Për lëshimin e Kartonit Jeshil në format elektronik, aplikimi i këtij formati është lënë në diskrecion të Byrove dhe kërkon ndryshime në kuadrin ligjor. Në këtë kuadër, AMF po harton dhe koordinon paketën ligjore për përafrimin me acquis të BE-së në fushën e sigurimeve, ku do të parashikohet mundësia e lëshimit të kontratës së sigurimit të detyrueshëm edhe në formën e dokumentit elektronik.

VII. Kushtet dhe detyrimet

35. Në mbështetje të nenit 50, pika 2, të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", sipas të cilit përjashtimet janë të kufizuara në kohë dhe mund të jepen me kushte dhe detyrime, vlerësohet që përjashtimi nga ndalimi i kësaj marrëveshjeje të jepet me kushtet dhe detyrimet e mëposhtme, me qëllim ruajtjen e konkurrencës në tregun përkatës, garantimin e pavarësisë së sjelljes tregtare të palëve dhe shmangien e koordinimit lidhur me kufizimin e produktit ose të shitjeve, ndarjen e tregut apo të klientëve dhe caktimin e çmimeve ose të primeve të sigurimit:

    i. Afati i marrëveshjes të jetë 2 vjeçar;

    ii. Secila ndërmarrje sigurimi, palë në marrëveshje, duhet ta tregtojë produktin "Karton Jeshil" nëpërmjet agjentëve të saj të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Polica e sigurimit duhet të përmbajë elementet identifikuese dhe të sigurisë të operatorit emetues, përfshirë logon e ndërmarrjes që e tregton, barkodin dhe kodin QR përkatës;

    iii. Ndërmarrjet palë në marrëveshje duhet të ruajnë pavarësinë në përcaktimin e politikave të tyre tregtare dhe të shmangin çdo koordinim të sjelljes lidhur me kufizimin e produktit ose të shitjeve, ndarjen e tregut apo të klientëve dhe caktimin e çmimeve ose të primeve të sigurimit;

iv. Palët në marrëveshje nuk duhet të shkëmbejnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, informacion tregtar individual dhe të ndjeshëm lidhur me çmimet ose primet aktuale dhe të ardhshme, komisionet, zbritjet, vëllimet e shitjeve, klientët apo strategjitë tregtare. Përjashtim përbën vetëm informacioni që kërkohet nga legjislacioni në fuqi ose nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si dhe informacioni që është objektivisht i domosdoshëm për funksionimin e Sistemit të Kartonit Jeshil. Në çdo rast, shkëmbimi duhet të kufizohet në përmbajtjen, shpeshtësinë dhe nivelin e detajimit të nevojshëm për arritjen e këtij qëllimi dhe nuk duhet të përdoret për koordinimin e sjelljes tregtare të palëve.

36. Kushtet dhe detyrimet e mësipërme synojnë të ruajnë pavarësinë e sjelljes tregtare të ndërmarrjeve palë në marrëveshje, të reduktojnë mundësinë e koordinimit ndërmjet tyre dhe të parandalojnë ndarjen e tregut apo të klientëve dhe bashkërendimin e çmimeve ose të primeve të sigurimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 5, nenin 24, shkronja (d), nenin 26, nenet 48-52 dhe nenin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të vazhdojë përjashtimin nga ndalimi Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes ndërmarrjeve të sigurimit lidhur me shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.

2. Marrëveshja përjashtohet nga ndalimi vetëm me respektimin e kushteve dhe detyrimeve të mëposhtme:

   i. Afati i përjashtimit të marrëveshjes të jetë për një periudhë 2 (dy) vjeçare, dhe hyn në fuqi që nga momenti i depozitimit të kërkesës së BSHS për zgjatjen e afatit të përjashtimit të ndalimit të marrëveshjeve për shitjen dhe administrimin e kartonit jeshil.

   ii. Secila ndërmarrje sigurimi, palë në marrëveshje, duhet ta tregtojë produktin "Karton Jeshil" nëpërmjet agjentëve të saj të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Polica e sigurimit duhet të përmbajë elementet identifikuese dhe të sigurisë të operatorit emetues, përfshirë logon e ndërmarrjes që e tregton, barkodin dhe kodin QR përkatës;

   iii. Ndërmarrjet palë në marrëveshje duhet të ruajnë pavarësinë në përcaktimin e politikave të tyre tregtare dhe të shmangin çdo koordinim të sjelljes lidhur me kufizimin e produktit

ose të shitjeve, ndarjen e tregut apo të klientëve dhe caktimin e çmimeve ose të primeve të sigurimit;

iv. Palët në marrëveshje nuk duhet të shkëmbejnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, informacion tregtar individual dhe të ndjeshëm lidhur me çmimet ose primet aktuale dhe të ardhshme, komisionet, zbritjet, vëllimet e shitjeve, klientët apo strategjitë tregtare. Përjashtim përbën vetëm informacioni që kërkohet nga legjislacioni në fuqi ose nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si dhe informacioni që është objektivisht i domosdoshëm për funksionimin e Sistemit të Kartonit Jeshil. Në çdo rast, shkëmbimi duhet të kufizohet në përmbajtjen, shpeshtësinë dhe nivelin e detajimit të nevojshëm për arritjen e këtij qëllimi dhe nuk duhet të përdoret për koordinimin e sjelljes tregtare të palëve.

3. T'i rekomandojë Byrosë Shqiptare të Sigurimit dhe shoqërive të sigurimit të përfundojnë procesin e implementimit të Kartonit Jeshil në format elektronik (PDF) dhe integrimin e kodit QR, në koordinim me AMF-në dhe në përputhje me kërkesat e Këshillit të Byrove, si dhe të informojnë Autoritetin e Konkurrencës mbi përfundimin e procesit, duke bashkëlidhur dokumentacionin mbështetës.

4. Në rast të mos respektimit prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuar në pikën 2, Komisioni i Konkurrencës do të ushtrojë kompetencën e tij të revokimit të këtij përjashtimi.

5. Çdo amendim i kësaj marrëveshjeje nga palët duhet të njoftohet për përjashtim pranë Autoritetit të Konkurrencës.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të kryen pagesat e parashikuara në rregulloren "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1326, Datë 11.09.2026

"PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME LEZHË SHA"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi vlerësimin e projektvendimit të Entit Rregullator të Ujit "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA.

VËREN SE:

1. Enti Rregullator i Ujit (ERRU) nëpërmjet shkresës nr. 620 prot., datë 01.09.2026 "Kërkohet vlerësimi i Autoritetit të Konkurrencës për projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator të ERRU-së" (protokolluar pranë AK nr. 752 prot., datë 03.09.2026), ka përcjellë për vlerësim projektvendimin "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA".

2. Projektvendimi është hartuar në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021 "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës kanalizime", i ndryshuar.

3. Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA ushtron aktivitetin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura në zonat e shërbimit Lezhë, Kurbin dhe Mirditë, përfshirë njësitë Rrëshen dhe Rubik.

4. Në vitin 2023, shoqëria paraqiti pranë ERRU-së kërkesën për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Kërkesa e operatorit parashikonte ndryshime të konsiderueshme të tarifave, me synimin, ndër të tjera, të unifikimit të tyre në zonën e shërbimit.

5. ERRU, pas analizës tekniko-ekonomike, vlerësoi se kërkesa për ndryshimin e nivelit tarifor ishte e justifikuar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria. Në kuadër të kësaj procedure, projektvendimi iu përcoll për komente edhe Autoritetit të Konkurrencës.

6. Në kuadër të vlerësimit të projektvendimit të vitit 2024, Autoriteti i Konkurrencës u shpreh me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1061, datë 6.03.2024 "Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA", ku vendosi t'i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

   i. *Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.*

   ii. *Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.*

   iii. *Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, Kurbin, Mirditë ndërmarrjen rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA seancat* e zhvilluara të dëgjesës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

7. ERRU, në Vendimin nr. 7, datë 06.03.2024 "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA", në vlerësimin ekonomik dhe financiar të tarifave mori në konsideratë kërkesat e ligjit nr. 9121/2003, veçanërisht sa i përket moslejimit të abuzimit me pozitën dominuese nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta ose kushteve të tjera të padrejta të tregtimit.

8. Në përfundim të procedurës, me Vendimin nr. 7, datë 06.03.2024, "Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA", Komisioni Kombëtar Rregullator miratoi nivelet tarifore për periudhën 2024–2025.

9. ERRU arriti në përfundimin se tarifat e miratuara në vitin 2024 ishin të bazuara në kostot e pranueshme dhe të justifikuara dhe në kriterin e përballueshmërisë dhe nuk ishin të padrejta apo të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik, në kuptim të ligjit nr. 9121/2003.

10. Referuar dokumentacionit të përcjellë nga ERRU, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA, me shkresën nr. 556, datë 26.06.2025, ka paraqitur kërkesë pranë ERRU-së për rishikimin e nivelit tarifor për shërbimet ujësjellës-kanalizime.

11. Me Vendimin e KKRR nr. 47, datë 29.12.2025, "Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshimin e nivelit tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Lezhë SHA", është vendosur fillimi i procedurës për shqyrtimin e aplikimit të operatorit.

12. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se, pavarësisht hapjes së procedurës për shqyrtimin e aplikimit tarifor, Shoqëria Rajonale UK Lezhë ka kërkuar mosndryshimin e tarifave ekzistuese, duke propozuar vijimin e aplikimit të nivelit tarifor të miratuar më parë nga ERRU.

13. Shoqëria e ka argumentuar kërkesën për mosndryshimin e tarifave, ndër të tjera, me faktin se niveli aktual tarifor i mundëson mbulimin mbi 100% të kostove operacionale, si dhe me nevojën për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve nëpërmjet investimeve të parashikuara. Gjithashtu, sipas relacionit të ERRU-së, tarifat aktuale mundësojnë mbulimin e shpenzimeve të riparimeve, eliminimin e defekteve dhe lidhjeve të paligjshme, instalimin e matësve, si dhe rregullimin dhe menaxhimin e rrjetit të furnizimit.

14. ERRU, gjatë procesit të analizës tekniko-ekonomike sipas metodologjisë së vendosjes së tarifave, ka kërkuar informacion të detajuar lidhur me të dhënat e raportuara nga operatori dhe, në vlerësimin e tarifave, ka marrë në konsideratë kuadrin rregullator të sektorit, mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol, kërkesat e ligjit nr. 9121/2003 për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese, orientimin e tarifave drejt mbulimit të kostove totale, si dhe treguesit teknikë dhe financiarë të operatorit.

15. Në përfundim të analizës tekniko-ekonomike, ERRU ka vlerësuar të justifikuar kërkesën e shoqërisë për mosndryshimin e nivelit tarifor për një periudhë rregullatore 2026–2030.

16. Nga krahasimi i tarifave të miratuara me Vendimin e KKRR nr. 7, datë 06.03.2024, me tarifat e parashikuara në projektvendimin objekt vlerësimi, rezulton se nuk ka ndryshim të nivelit tarifor për asnjë nga kategoritë e klientëve dhe për asnjë nga njësitë e shërbimit.

17. Për rrjedhojë, projektvendimi i ri nuk sjell rritje të çmimit të shërbimit për konsumatorët, nuk ndryshon diferencimin tarifor ndërmjet kategorive familjare, publike dhe private dhe nuk ndryshon strukturën tarifore ndërmjet njësive të shërbimit.

18. Shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura karakterizohen nga tiparet e monopolit natyror dhe ofrohen në zona të përcaktuara shërbimi. Për këtë arsye, në vlerësimin nga pikëpamja e konkurrencës merr rëndësi kontrolli rregullator i nivelit të tarifave, orientimi i tyre drejt kostos dhe zbatimi i kushteve objektive, transparente dhe jodiskriminuese ndaj kategorive të klientëve.

19. Në kuadër të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003, vendosja në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit mund të përbëjë një formë abuzimi me pozitën dominuese. Për këtë arsye, në procedurat e miratimit të tarifave të operatorëve që ushtrojnë aktivitet në tregje të rregulluara, është e rëndësishme që tarifat të jenë të lidhura me kostot e justifikuara të ofrimit të shërbimit dhe të mos krijojnë trajtim të pajustifikuar ndërmjet kategorive të klientëve.

20. Në rastin konkret duhet marrë në konsideratë, së pari, se nivelet tarifore që propozohen për periudhën 2026–2030 janë të njëjta me ato të miratuara me Vendimin nr. 7/2024, për të cilat Autoriteti i Konkurrencës është shprehur në procedurën e mëparshme.

21. Së dyti, ndryshe nga procedura e vitit 2024, në të cilën objekti i shqyrtimit ishte një ndryshim efektiv i nivelit tarifor, në procedurën aktuale operatori nuk kërkon rritje të tarifave. Vendimi nr. 7/2024 kishte miratuar nivele të reja tarifore për vitet 2024–2025, ndërsa vetë dokumentacioni i asaj kohe evidentonte se me tarifat e miratuara operatori ende nuk arrinte të mbulonte mbi 100% të kostove O&M.

22. Në procedurën aktuale, sipas analizës së ERRU-së, situata rezulton e ndryshme për sa i përket performancës ekonomike të operatorit, pasi shoqëria mbulon mbi 100% të kostove O&M. Për rrjedhojë, operatori nuk ka propozuar rritjen e tarifave, por mbajtjen e tyre në nivelin ekzistues.

23. Ky element është relevant nga pikëpamja e konkurrencës, pasi përmirësimi i mbulimit të kostove operacionale nuk është shoqëruar me një kërkesë për rritje të mëtejshme të tarifave për konsumatorët. Njëkohësisht, mbajtja e tarifave të pandryshuara duhet të shihet në lidhje me detyrimet dhe objektivat e performancës të përcaktuara nga ERRU për operatorin gjatë periudhës së re rregullatore.

24. Nga projektvendimi rezulton se ERRU ka përcaktuar një sërë masash lidhur me reduktimin e Ujit Pa të Ardhura, përmirësimin e nivelit të matjes, modernizimin dhe automatizimin e monitorimit të rrjetit, përmirësimin e faturimit dhe administrimit të klientëve, rritjen e

arkëtimeve, trajtimin e ankesave të konsumatorëve, mirëmbajtjen e infrastrukturës, menaxhimin e aseteve, eficiencën e stafit dhe kontrollin e kostove të energjisë.

25. Këto masa marrin rëndësi edhe për vlerësimin e proporcionalitetit të tarifave, pasi eficienca e operatorit, reduktimi i humbjeve dhe kontrolli i kostove ndikojnë drejtpërdrejt në nevojën për të ardhura tarifore dhe, rrjedhimisht, në nivelin e tarifave që u ngarkohen konsumatorëve.

26. Nga ana tjetër, periudha e re e propozuar e zbatimit të tarifave është 2026–2030, krahasuar me periudhën 2024–2025 të Vendimit nr. 7/2024. Për këtë arsye, edhe pse tarifat nuk ndryshojnë në momentin e miratimit, rëndësi merr monitorimi i performancës së operatorit dhe i kostove të tij gjatë periudhës rregullatore, në mënyrë që niveli tarifor të vazhdojë të jetë i justifikuar nga kostot dhe eficienca e shërbimit.

27. Vetë projektvendimi parashikon objektiva të treguesve të performancës dhe detyrime të posaçme për operatorin, si dhe monitorimin periodik të zbatimit të rekomandimeve. Në këtë kuptim, mekanizmat e monitorimit të ERRU-së përbëjnë një element të rëndësishëm për të garantuar që mbajtja në fuqi e tarifave për një periudhë më të gjatë të shoqërohet me kontrollin e vazhdueshëm të kostove dhe performancës së operatorit.

28. Gjithashtu, duhet mbajtur në konsideratë se diferencimi ekzistues i tarifave sipas kategorive të klientëve dhe njësive të shërbimit nuk ndryshon në raport me strukturën tarifore të miratuar në vitin 2024. Për rrjedhojë, projektvendimi aktual nuk krijon diferencime të reja tarifore nga pikëpamja e parimit të mosdiskriminimit.

29. Nga ana tjetër, miratimi i të njëjtit nivel tarifor për një periudhë rregullatore nga viti 2026 deri në vitin 2030, kërkon që evoluimi i kostove dhe i performancës së operatorit gjatë kësaj periudhe të ndiqet në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që të verifikohet nëse kushtet ekonomike dhe treguesit mbi të cilët është mbështetur miratimi i këtyre tarifave vijojnë të justifikojnë nivelin e tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, germa (d) e (f); 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

   i. Të monitorojë kostot, eficiencën dhe treguesit e performancës së Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë SHA gjatë periudhës së zbatimit të tarifave të miratuara për

vitet 2026–2030, me qëllim që niveli i tyre të vijojë të jetë i orientuar drejt kostove të justifikuara dhe zbatimi i tyre të bëhet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1327, Datë 11.09.2026

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES
"PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR ZBATIMIN E NENEVE 4 DHE 9 TË LIGJIT NR. 9121/2003 NË SEKTORIN E TRANSPORTIT DETAR, PËRFSHIRË KABOTAZHIN DHE SHËRBIMET NDËRKOMBËTARE TË LUNDRIMIT TË LIRË (TRAMP SERVICES)"

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.09.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 në sektorin e transportit detar, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (tramp services)"

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

- Draft - rregullores "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 në sektorin e transportit detar, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (tramp services)",

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e neneve 4 dhe 9 të ligjit nr. 9121/2003 në sektorin e transportit detar, përfshirë kabotazhin dhe shërbimet ndërkombëtare të lundrimit të lirë (tramp services)", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1328, Datë 28.09.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM, TË PROPOZUAR, PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË SHOQËRISË BANCA MONTE DEI PASCHI DI SIENA S.P.A. NGA SHOQËRIA INTESA SANPAOLO S.P.A."

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.09.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm, të propozuar, për përftimin e kontrollit të shoqërisë BANCA MONTE DEI PASCHI DI SIENA S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A..

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit të shoqërisë BANCA MONTE DEI PASCHI DI SIENA S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar lidhur me transaksionin e synuar të përftimit të kontrollit, të shoqërisë BANCA MONTE DEI PASCHI DI SIENA S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A, nëpërmjet një oferte publike.

   Referuar dokumentacionit të paraqitur, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

2. **Pala ofertuese: Intesa Sanpaolo S.p.A.** është një shoqëri aksionare e themeluar dhe ekzistuese sipas legjislacionit Italian, e listuar në Bursën Italiane të Shkëmbimit të Aksioneve. Intesa Sanpaolo S.p.A. ka objekt kryesor ofrimin e shërbimeve bankare, investimeve bankare, financë të strukturuar, tregje kapitali etj. Intesa Sanpaolo S.p.A. është shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo, një prej grupeve bankare kryesore në Europë.

Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

3. Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit Shqiptar. Objekti i aktivitetit përfshin: veprimtari bankare, veprimtari financiare dhe veprimtarinë e kasave të sigurimit, pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë, veprimtari të lidhura me transaksionet e titujve, vetëm pasi të jetë licencuar nga AMF dhe veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime në përputhje me Ligjin Nr.52/2014.
4. **Shoqëria Target: BANCA MONTE DEI PASCHI DI SIENA S.p.A./MPS** është një shoqëri aksionare e regjistruar, sipas legjislacionit Italian, dhe është shoqëria mëmë e Grupit MPS. Grupi MPS është aktiv kryesisht në bankingun me pakicë dhe komercial, me aktivitete shtesë në leasing, factoring, financa të korporatave, bankingun e investimeve, bankingun dhe shpërndarjen e menaxhimit të aseteve.
5. BANCA MONTE DEI PASCHI DI SIENA S.p.A. nuk ka asnjë filial të regjistruar në Shqipëri dhe nuk është aktive në tregun shqiptar.

II. Përqendrimi

6. [_____].
7. [_____].
8. [_____].
9. Nga vlerësimi paraprak i aktivitetit të palëve pjesëmarrëse në transaksion, konstatohet se përqendrimi i njoftuar nuk pritet të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.
10. [_____].
11. [_____].
12. Për sa më sipër dhe mbështetur në kërkesën e palës njoftuese, Komisioni i Konkurrencës gjykon se është në kushtet e dhënies së një autorizimi të përqendrimit të përkohshëm në kuptim të nenit 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 dhe nenit 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e propozuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë BANCA MONTE DEI PASCHI DI SIENA S.p.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e depozitimit të publikimit të ofertës nga palët pjesëmarrëse në transaksion.

3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, publikimin e ofertës nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1329, Datë 28.09.2026

"MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR PËR PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË IRCA GROUP LUXEMBOURG MIDCO 4 S.À.R.L. NGA SHOQËRIA IBERT INVESTMENTS S.À.R.L.".

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.09.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë IRCA Group Luxembourg Midco 4 S.à.r.l. nga shoqëria Ibert Investments S.à.r.l.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës"; Rregullorja "Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve"; Udhëzimi "Për formën e njoftimit të përqendrimit", Udhëzimi "Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve "Rasti i përftimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë IRCA Group Luxembourg Midco 4 S.à.r.l. nga shoqëria Ibert Investments S.à.r.l.",

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

1. Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e propozuar të përftimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë IRCA Group Luxembourg Midco 4 S.à.r.l. nga shoqëria Ibert Investments S.à.r.l.
2. Referuar dokumentit "Marrëveshje Shitblerje", palët në marrëveshje janë:
3. **Blerësi: Ibert Investments S.à.r.l.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut. Objekti i shoqërisë është të fitojë interesa, në çdo formë, në Luksemburg dhe në shoqëri të huaja, të fitojë me anë të blerjes, si dhe të transferojë me anë të shitjes, këmbimit aksione, obligacione, letra të tjera me vlerë dhe të zotërojë, administrojë, zhvillojë, menaxhojë portofolin e saj. Shoqëria gjithashtu mund të fitojë interesa në partneritete të kufizuara dhe të veprojë si partner i përgjithshëm në këto partneritete etj.

4. Ibert Investments S.à.r.l. është një mjet investimi i themeluar rishtazi, i zotëruar dhe financuar në formë indirekte nga Fondet CVC, një menaxher global i investimeve alternative, i fokusuar në investimet në kapital privat, kredi, infrastrukturë dhe investime dytësore.
5. Shoqëritë e kontrolluara të portofolit të rrjetit CVC gjenerojnë të ardhura në tregun shqiptar, nëpërmjet aktiviteteve të një numri të limituar të shoqërive të kontrolluara të portofolit të rrjetit CVC.
6. **Shitësi: IRCA Group Luxembourg Midco 3 S.à.r.l.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin sipas legjislacionit të Dukatit të Madh të Luksemburgut.
7. **Shoqëria target: IRCA Group Luxembourg Midco 4 S.à.r.l.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut. Objekti i shoqërisë është të veprojë si një shoqëri holding investimesh dhe të koordinojë veprimtarinë e të gjitha entiteteve në të cilat shoqëria ka një interes të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, si dhe të fitojë (qoftë nëpërmjet ofertës publike, blerjes, shkëmbimit) të gjithë ose një pjese të kapitalit, aksioneve, obligacioneve, bonove ose letrave të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga çdo person dhe çdo aktiv tjetër, si dhe t'i mbajë ato si investime, t'i shesë, t'i shkëmbejë dhe t'i disponojë ato; të mbajë të gjitha aksionet, obligacionet dhe letrat e tjera me vlerë të fituara në këtë mënyrë etj.
8. IRCA Group Luxembourg Midco 4 S.à.r.l., së bashku me filialet që zotëron në mënyrë direkte dhe indirekte përbëjnë Grupin IRCA, një grup shoqërish i angazhuar në prodhimin dhe shpërndarjen e përbërësve ushqimorë, produkteve gjysmë të gatshme dhe produkteve të gatshme për industrinë e ëmbëlsirave, akullores dhe produkteve të furrës.
9. Shoqëria Target nuk ka prezencë në Shqipëri, por gjeneron të ardhura në tregun shqiptar.

II. Përqendrimi

10. Më datë 26 qershor 2026, ndërmjet shoqërive Ibert Investments S.à.r.l. (blerësi), IRCA Group Luxembourg Midco 3 S.à.r.l. (shitësi), në lidhje me dhe në prani të IRCA Group Luxembourg Midco 4 S.à.r.l. (Shoqëria target), është nënshkruar "Marrëveshje Shitblerje" në lidhje me shitjen e të gjitha aksioneve në IRCA Group Luxembourg Midco 4 S.à.r.l.
11. Referuar kësaj marrëveshje, shitësi do të shesë aksionet dhe blerësi do të blejë aksionet me të gjitha të drejtat që u bashkëngjiten atyre në momentin e Mbylljes.
12. Shitja dhe blerja së aksioneve është e varur dhe e kushtëzuar nga plotësimi i kushteve të parashikuara në marrëveshje.
13. Pas implementimit të transaksionit të propozuar, Fondet CV, nëpërmjet Ibert Investments S.à.r.l. do të përftojnë 100% të kapitalit aksionar dhe kontrollin e vetëm mbi shoqërinë target.
14. Për sa më sipër, transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë IRCA Group Luxembourg Midco 4 S.à.r.l. nga shoqëria Ibert Investments S.à.r.l., duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003

"Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe si i tillë do të jetë objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

15. Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si edhe Udhëzimit nr. 76, datë 07.04.2008 "Për përcaktimin e tregut përkatës", treg përkatës do të konsiderohet tregu i furnizimit me shumicë të përbërësve ushqimorë, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar si edhe duke iu referuar praktikave të mëparshme në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.
16. Transaksioni i propozuar konsiston në përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë IRCA Group Luxembourg Midco 4 S.à.r.l. nga shoqëria Ibert Investments S.à.r.l.
17. Ibert Investments është një mjet investimi i krijuar rishtazi, i zotëruar dhe i financuar në formë indirekte nga Fondet CVC.
18. IRCA Group Luxembourg Midco 4 S.à r.l. së bashku me filialet që zotëron në mënyrë direkte dhe indirekte përbëjnë IRCA Group, i cili është i angazhuar në prodhimin dhe shpërndarjen e përbërësve ushqimorë, produkteve gjysmë të gatshme dhe produkteve të gatshme për industrinë e ëmbëlsirave, akullores dhe produkteve të furrës.
19. Gjatë vitit 2025, asnjë nga Shoqëritë e Kontrolluara të Portofolit të Rrjetit CVC nuk ka ushtruar veprimtari në të njëjtat segmente si Grupi IRCA, e për rrjedhojë, transaksioni nuk krijon mbivendosje horizontale ndërmjet Palëve dhe nuk ekzistojnë marrëdhënie vertikale ndërmjet Grupit IRCA dhe Shoqërive të Kontrolluara të Portofolit të Rrjetit CVC në Shqipëri.
20. Ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës",

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar për përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë IRCA Group Luxembourg Midco 4 S.à.r.l. nga shoqëria Ibert Investments S.à.r.l.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja "Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

2026

VENDIMET E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS

2026

BULETINI ZYRTAR

AUTORITETI I KONKURRENCËS